



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Financë-Bankë”

Kolegji Universitar “Wisdom”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dr. Gentiana SHARKU

Dr. Valbona KAPLLANI

Korrik / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Financë Bankë"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Wisdom"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në "Financë Bankë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 241, datë 31.05.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 237, date 23.11.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 72, datë 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 20 studentë; 2020-2021 12 studentë; 2021-2022 8 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 241, datë 31.05.2011 dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.72, 17.10.2018, me rekomandime për t’u plotësuar nga institucioni. Ky program mbulohet nga Departamenti i Ekonomisë në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të Kolegjit Universitar “Wisdom”. Kolegji Universitar “Wisdom” e ka filluar aktivitetin e tij si institucion i arsimit të lartë në vitin 2006 dhe në vitin 2008 është licënsuar si Shkollë e lartë Universitare Jopublike “Wisdom”. Pas akreditimit të parë në vitin 2015, është riakredituar me Vendim nr. 103, datë 10.11.2018 nga Bordi i Akreditimit, nën emërtimin Kolegji Universitar “Wisdom”.

Programi i studimeve “Bachelor në Financë-Bankë” është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit, si pjesë e sferës së financës. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Financë-Bankë”.

Objektivi kryesor i këtij programi është të pajisë studentët me aftësitë e duhura për formimin e studentëve në fushat e Financës dhe Bankës në mënyrë që të përgatisë specialistë të aftë për tregun e punës ose për të vazhduar kualifikimin në ciklin e dytë të studimeve. Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” ka për qëllim t’u japë studentëve parimet bazë teorike dhe praktike të financave dhe bankingut, nëpërmjet përvetësimit të njohurive, metodave dhe teknikave të analizës së performancës drejtuese, ekonomike, financiare, manaxheriale, të marketingut, të burimeve njerëzore të subjekteve publike dhe private.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.72, datë 17.10.2018.

1. Institucioni përpara fillimit të vitit akademik 2019-2020, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit, duke pakësuar numrin e lëndëve të fushës së menaxhimit dhe duke shtuar lëndë të fushës së financës dhe kontabilitetit, duke respektuar cilësinë, kapacitetet pedagogjike dhe kualifikimin e tyre, si dhe përqindjen e lejuar të ndryshimeve për programet e akredituarara;

GVJ mendon se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**: Sikurse raportohet në RVB, ndryshimi konsiston në zëvendësimin e lëndës “Menxhim Strategjik” me “Parimet e Kontabilitetit”. Dy ndryshimet e tjera të kryera (lënda “Tregje Financiare” u zëvendësua me lëndën “Tregje dhe Institucione Financire” dhe lënda “Kontabilitet Kosto” u zëvendësua me lëndën “Kontabilitet Kosto dhe Drejtimi”), janë ndryshime që nuk lidhen me rekomandimin e bërë pasi zëvendësohen lëndë të së njëjtës fushë (Financë-Kontabilitetit). Gjithashtu, GVJ vëren sikurse është shprehur edhe në raport që lënda e praktikës përmban tema tërësisht nga fusha e Menaxhimit.

2. Institucioni brenda vitit akademik 2018-2019 të specifikojë objektiva të qarta për programin e studimit në kuadër të strategjisë së tij, si dhe perpektivën e zhvillimit të një programi të ciklit të dytë në këtë fushë mbështetur në tregues konkretë;

GVJ mendon se ky rekomandim është **përbushur kryesisht**: Lidhur me objektivat e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” duhet të përcaktohen më qartë në rregulloren e programit të studimit (Plani Strategjik 2019-2022 për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” mungon). Studimi i tregut për këtë program i referohet më shumë rëndësisë që sektori bankar ka në ekonominë e vendit se sa lidhur me nevojën e këtij sektori për këtë program studimi. Nisur edhe nga statistikat e të diplomuarve, GVJ konstaton se nuk ka raportime për të punësuar në banka. Pjesa më e madhe e të diplomuarve punojnë në biznese private. Për këtë arsye mendojmë që objektivat e programit të studimit duhet të zgjerohen përtej sektorit bankar.

Lidhur me pjesën e dytë të rekomandimit, GVJ mendon se ky rekomandim është **përbushur, plotësisht**, sepse Departamenti i Ekonomisë ka aplikuar për liçensimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Financë-Bankë” duke u dhënë mundësi studentëve të tyre të vazhdojnë studimet e mëtejshme.

3. Institucioni të intensifikojë përpjekjet dhe të gjejë mekanizma dhe instrumente për të pasuruar bashkëpunimet me institucione homologe jashtë vendit si dhe të rrisë pjesëmarrjen në programe ndër-universitare në kuadër të projekteve të BE si Erasmus+ etj;

GVJ gjykon se ky rekomandim është *përmbushur plotësisht*. Institucioni ka shtuar përpjekjet për përfshirje në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare duke rritur mundësinë e kualifikimeve të personelit akademik të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë”.

4. Institucioni të përmirësojë formatimin e syllabuseve, në strukturë dhe përmbajtje, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, përfshitë në të edhe përmirësimin dhe përditësimin e literaturës së rekomanduar, dhe plotësimin me të gjithë elementët e kërkuar;

GVJ konstaton se ky rekomandim është *përmbushur kryesisht*. Pjesa më e madhe e programeve mësimore të lëndëve është formatuar dhe përmban elementët e kërkuar sipas akteve ligjore në fuq, me përjashtim të dy-tre lëndëve për të cilat mënyra e vlerësimit të studentëve mungon ose nuk është shumë e qartë, si dhe përmbajta e lëndës së praktikës rezulton me tema tërësisht nga fusha e Menaxhimit përkundrejt fokusit të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë”.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 16.11.2021, Kolegji Universitar “Wisdom” ka aplikuar nëpërmjet sistemit AMS, për nisjen e procesit të vlerësimit të programit të studimit të Ciklit të Parë “Bachelor në Financë-Bankë”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji Universitar “Wisdom”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës dhe Dr. Valbona Kapllani, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli.

Në datën 05.05.2022, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 13 dhe 14 Qershor 2022 në ambientet e Kolegjit Universitar “Wisdom”. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 21.06.2022.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Kolegji Universitar “WISDOM”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.07.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 129/2 Prot, datë 14.07.2022. Kolegji Universitar “WISDOM”, përcjell në ASCAL më datë 19.07.2022, me anë të shkresës me Nr. 138 Prot, datë 18.07.2022, “Mendim për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë-Bankë”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Kolegji Universitar “Wisdom” (referuar shkurt si “KUW” në këtë raport vlerësimi) është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili angazhohet në ofrimin e programeve të studimit që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. I riorganizuar në vitin 2017 (dikur Shkolla e Lartë Jopublike “Wisdom University”), KUW e zhvillon veprimtarinë në përputhje me parashikimet e nenit 57, pika 7 të Kushtetutës, me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore duke pasqyruar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.</p> <p>Nenet 3 dhe 4 të Statutit të KUW shprehin qartë objektin, misionin dhe qëllimin e veprimtarisë së institucionit duke theksuar si baza të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ndërthurjen e traditës morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore kombëtare me eksperiencën më të mirë ndërkombëtare. Përmes programeve të studimeve që ofron, KUW synon të jetë një qendër për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence për formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve juridike, sociale dhe ekonomike, si dhe një qendër ekselence për kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar.</p> <p>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.03 Plani strategjik KUW.pdf;]</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	

<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të KUW, në përgjegjësi të Departamentit të Ekonomisë, është program i ciklit të parë të studimeve, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me një total prej 180 kredite (ECTS). Ky program studimi ka për mision përgatitjen e specialistëve në fushën e Financave dhe Bankave dhe aftësimin e tyre për një trajtim bashkëkohor dhe integral të çështjeve në këtë fushë. GVJ vlerëson se ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e KUW të shprehur në Statutin dhe në Rregulloren e institucionit, si dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij. KUW përmes programeve të studimit synon që t’i shërbejë dijës së shoqërisë shqiptare duke u dhënë studentëve një edukim cilësor, të integruar me arritjet më të mira shkencore dhe me bashkëpunime të vlefshme me tregun e punës, lokale dhe ndërkombëtare. Vizioni i zhvillimit strategjik të KUW është jo vetëm përgatitja e specialistëve të kualifikuar, por edhe përgatitja e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të kulturuar në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit cilësor dhe të qendrueshëm të vendit.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.03 Plani strategjik KUW.pdf; 2.09 Studim periodik tregu.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (DVV) dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të KUW, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit në kushtet e integritetit europian. Ndër të tjera, Plani Strategjik i Zhvillimit synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimin, zhvillimin, përhapjen, konsolidimin dhe mbrojtjen e një baze të gjerë dhe të përshtatshme dijesh

	<p>në shërbim të vendit me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe shërbimeve të tjera në shkencat juridike, ekonomike dhe sociale në përshtatje me zhvillimet shqoërore dhe ekonomike në vend;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi dhe atij rajonal në veçanti, përmes formimit të një brezi studentësh të kualifikuar dhe të aftë për të përballuar sfidat; ▪ Të jetë një IAL jo-masiv në numër studentësh dhe programesh të ofruara, por një institucion cilësor që kombinon rritjen e kujdesshme me ruajtjen e standardeve më të mira akademike e pedagogjike në të dy ciklet e studimeve etj; <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.03 Plani strategjik KUW.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se Statuti dhe Rregullorja e KUW janë bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe demonstrojnë se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtij kuadri.</p> <p>Në Statut theksohet se ndër të tjera KUW ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofrimin e studimeve të plota universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë, studime të integruara dhe profesionale, në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë; ▪ Kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë dhe jo vetëm; ▪ Garantimin e cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, me metoda të avancuara dhe bashkëkohore; ▪ Vendosjen e lidhjeve të forta dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe administratën shtetërore dhe biznesin në veçanti, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit afatgjata dhe të larmishme; <p>Përmes programeve të studimeve që ofron, KUW synon të jetë një qendër për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence për formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve juridike, sociale dhe ekonomike, si dhe një qendër ekselence për kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është emërtuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të KUW dhe të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (FSHESH) të tij.</p> <p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë i FSHESH, që në ciklin e parë të studimeve pranë KUW mbulon edhe programin e studimit “Bachelor në Administrim Biznesi” dhe në ciklin e dytë të studimeve mbulon programin e studimit “Master i Shkencave në Administrim Biznesi”.</p> <p>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” (neni 6), përcakton si objektiva këtij program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitjen e specialistëve në fushën Financë-Bankë; ▪ Përgatitjen e studentëve për studime të pavarura përmes njohjes së metodave, instrumentave e teknikave të zbatuara në këtë fushë; ▪ Dhënien e parimeve bazë teorike, zhvillimin e tyre dhe njohjen e metodave të zbatueshme në këtë fushë; ▪ Përcaktimin e modeleve dhe mjeteve të përshtatshme të analizës, për një përfaqje kritike të çështjeve në fushën e financave dhe bankave; ▪ Përgatitja për praktikën profesionale të pavarur si drejtues apo të punësuar të subjekteve publike dhe private, si dhe për të ofruar shërbime si profesionistë të lirë në fushën e konsulencës.

	<p>GVJ vlerëson se objektivi për këtë program studimi është i formuluar qartë dhe në përputhje me qëllimin dhe misionin e KUW.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 3.01 Rregullore e prog. studimit FB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se gjatë periudhës “dhjetor 21 - shkurt 22”, një grup pune i ngritur pranë Departamentit të Ekonomisë ka realizuar Studimin e Tregut për Programin e Studimit në Financë-Bankë për të vlerësuar zhvillimet e tregut të punës me objektivin për të vlerësuar kërkesën për specialistë të fushës së financës dhe bankës.</p> <p>Grupi i punës për studimin e tregut ka përdorur një metodologji cilësore të analizës së të dhënave, të mbledhura kryesisht nga burime dytësore, si publikime të INSTAT, të Bankës së Shqipërisë, të Shoqatës Shqiptare të Bankave etj. Gjithashtu, GVJ konstatoi se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave mbi ecurinë studentëve pas diplomimit realizohet nga Specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore të KUW.</p> <p><i>GVJ vlerëson angazhimin e KUW në realizimin e studimit të tregut dhe mbledhjen e të dhënave mbi punësimin e studentëve por konstaton se analiza në studimin e tregut për këtë PS mbetet në nivele përshkruese. Përfundimet janë jo të plota dhe mungon përfaqësia me ecurinë e studentëve pas diplomimit duke lënë shteg për subjektivitet në vlerësim.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.09 Studim periodik tregu.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në përgjithësi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë në funksion të objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe kompetencave të synuara për studentët e këtij programi studimi. Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” parashikon një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike dhe një total prej 180 kredite (ECTS) të shpërndara midis lëndëve/moduleve në përputhje me VKM nr. 41. Ky program studimi ka për mision përgatitjen e specialistëve në fushën e Financave dhe Bankave dhe aftësimin e tyre për një trajtim bashkëkohor dhe integral të çështjeve në këtë fushë. Sikurse parashikon edhe rregullorja e programit të studimit, dhe nga shqyrtimi i planit mësimor dhe</p>

	<p>programeve mësimore (syllabuseve), GVJ konstatoi se programi i studimit është i ngjashëm me programe që ofrohen nga institucione ndërkombëtare dhe organizimi me kredite lehtëson transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve në tregun ndërkombëtar të punës.</p> <p>[Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Duk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Kolegji Universitar “Wisdom” (KUW) i ka fillesat e aktivitetit në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom” të krijuar bazuar në VKM nr.672 të vitit 2006 dhe të licënuar me VKM nr.254 të vitit 2008. Struktura aktuale akademike është rezultat i riorganizimit të bërë në vitin 2017, me Vendimin nr.6 të Senatit Akademik të KUW dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.80/2015.</p> <p>KUW përbëhet nga dy njësi kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fakulteti i Drejtësisë; ▪ Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore; <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (FSHESH) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomisë; • Departamenti i Psikologjisë; dhe • Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (FSHESH) për vitin akademik 2021- 2022 ka 32 pedagogë gjithsej, nga të cilët 24 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë i Asociuar”, 10 kanë gradën Dr., dhe 11 Asistent Lektorë me Msc, dhe 8 janë personel akademik me kontratë (PAK).</p>

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Fakulteti për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:

PAE /Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Profesor	1	1	1
Profesor i Asociuar	2	2	2
Doktor/Docent	11	13	10
Msc.	8	7	11
Totali	22	23	24

Programi “Bachelor në Financë-Bankë” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë. Në ciklin e parë të studimeve pranë FSHESH, ky departament mbulon edhe programin e studimit “Bachelor në Administrim Biznesi” dhe në ciklin e dytë mbulon programin e studimit “Master Shkencor në Administrim Biznesi”.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Departamenti përgjegjës për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:

PAE /Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Profesor	1	1	1
Profesor i Asociuar	1	1	1
Doktor/Docent	2	4	4
Msc.	4	3	4
Totali	8	9	10

Gjatë periudhës 2019 – 2021, programi i studimit është realizuar në masën 80% - 92 % me personel akademik efektiv (PAE).

Në këtë program për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar gjithsej 15 pedagogë si personel akademik, nga ku 12 janë personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët, 1 Prof.Dr, 1 Prof.As., 4 Dr dhe 6 me Msc, dhe 3 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët 1 Prof.AS, 1 Dr dhe 1 me Msc.


GVJ konstaton se personeli akademik i këtij departamenti dhe veçanërisht personeli i angazhuar në këtë program studimi demonstroi se ka përvojën dhe kualifikimet e nevojshme, si

	<p>dhe disponon kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi.</p> <p>[Referenca: 2.21 Te dhena tab personel akademik.pdf; 2.22.1 Cve stfajit akademik te prog & ndihmes.pdf; Informacion shtese.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është program i ciklit të parë të studimeve, referuar nivelit 6-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i organizuar me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me një total prej 180 kredite (ECTS), në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015. Ky program studimi ka për mision përgatitjen e specialistëve në fushën e Financave dhe Bankave, fushë që përputhet me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.</p> <p>Fusha që mbulon ky program studimi përputhet tërësisht me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë, i cili ka si mision kryesor përgatitjen dhe formimin e studentëve në fushën e Financave dhe Bankave.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Për realizimin e këtij programi studimi, Departamenti i Ekonomisë mbështetet edhe nga Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë të FSHESH. Klasifikimi/kodifikimi i elementëve të programit të studimit është bërë në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p> <p>[Referenca: 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në funksion të realizimit të programeve të tij të studimit, KUW ka hartuar një sërë rregulloresh dhe dokumentash, përmes të cilave mbikqyr mbarëvajtjen e tyre. Statuti i KUW përcakton strukturat akademike dhe administrative të organizimit të institucionit dhe garanton bashkëpunimin dhe ndarjen e detyrave e përgjegjësisë mes këtyre strukturave. Rregullorja e KUW, rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e njësisë bazë përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të departamentit, personelit akademik si dhe të personelit ndihmës akademik. Njësia bazë ku zhvillohet programi i studimit është departamenti i Ekonomisë, i mbështetur nga Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë të FSHESH. GVJ konstaton se procesi i mbikëqyrjes dhe mbarëvajtjes së programit të studimit bëhet në mënyrë të koordinuar dhe në bazë të përgjegjësisë të parashikuara në rregulloret përkatëse. Gjithashtu në proces përfshihen edhe strukturat pranë Komisioneve të Përhershme të KUW për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulat, si dhe kordinatori i programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 2.13 Vendim per kordinatorin.pdf; 2.13.1 Relacion i kordinatorit.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUW ka në fokus të punës së tij vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit përmes pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta dhe nënshkrimit të një sërë marrëveshjeve për bashkëpunim me interes reciprok. Aktualisht në nivel institucioni dhe njësie kryesore (KUW dhe FSHESH), janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike vendase dhe sipërmarrje private. Në shërbim të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” janë lidhur 12 marrëveshje bashkëpunimi kryesisht për realizimin e praktikave profesionale.</p>



	[Referenca: 1.03 Plani strategjik KUW.pdf; 4.04.1 MB NE RANG IAL.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Gjithashtu, bazuar në sa më sipër, GVJ konstatoi se përfitimet kryesore nga këto marrëveshje bashkëpunimi lidhen me mobilitete të studentëve dhe të personelit akademik të Departamentit të Ekonomisë, realizimin e workshop-eve, trajnimeve dhe leksioneve të hapura për personelin dhe studentët, si edhe me zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Departamenti i Ekonomisë së bashku me Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë të FSHESH, analizojnë në mënyrë të rregullt rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit si pjesë të analizës së tyre vjetore si departamente. [Referenca: 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; 4.01 Raport Vjetor NJSKSHMJ.pdf; 4.01.1 Raport per perfitimet e MB.pdf]			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se KUW ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale në përgjithësi dhe për këtë program studimi në veçanti, në nivel fakulteti kryesisht me institucione publike rajonale dhe sipërmarrje private. Dokumentacioni për praktikën profesionale të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” përmban të gjithë elementët e nevojshëm për rregullimin e marrëdhënieve mes studentëve, institucionit pritës për realizimin e praktikës dhe Departamentit të Ekonomisë (udhëzues, marrëveshje, rregullore, formularë vlerësimi etj) dhe një ecuri të suksesshme të praktikës së parashikuar në këtë program studimi. [Referenca: 3.12 Udhezues per praktikat bachelor.pdf; 4.03 Tabelat permbledhese dhe MB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që në KUW realizohen trajnime me natyrë profesionale për studentët aktualë dhe në proces diplomimi, në kuadrin edhe të marrëveshjeve dhe projekteve të bashkëpunimit në fuqi, por nuk rezultoi që për vitin akademik 2020-2021 të jetë kryer ndonjë trajnim profesional i mëtjeshëm për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nat. përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është liçensuar me UMASR, nr. 241, datë 31.05.2011. Ai organizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program, që i takon ciklit të parë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në 6 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 180 kredite. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 24 lëndë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse (punim diplome ose provim përfundimtar). [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf]
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Bazuar në informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” ofron për studentët mbulim të hollësishëm të teorisë dhe njohurive teknike, nxit të menduarin kritik, përgatit specialistë me njohuri akademike dhe praktike të fushës së financave në përgjithësi dhe sektorit bankar në veçanti, si dhe mundëson studimet dhe specializimin e mëtejshëm në këtë fushë dhe sektor. Ky program studimi synon të përgatisë specialistë të aftë për një trajtim të plotë dhe bashkëkohor të çështjeve në fushën e financave dhe sektorit bankar të cilët në përfundim të studimeve do të mund të ofrojnë shërbimet e tyre pranë njësive ekonomike publike apo private si specialistë të punësuar, drejtues apo si profesionistë të lirë këshillues.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe	Lëndët karakterizuese dhe ndërdisiplinore përfshijnë lëndë si: “Hyrje në Financë”, “Parimet e Kontabilitetit”, “Kontabiliteti

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Financiar”, “Kontabiliteti i Kostos & Drejtimi”, “Drejtimi Financiar”, “Analiza Financiare”, “Investimet”, “Financa Publike”, “Paraja dhe Banka” dhe “Tregjet dhe Institucionet Financiare” duke mbuluar thujtë të gjithë sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë.</p> <p>Gjithashtu, nga shqyrtimi i planit mësimor, syllabuseve të lëndëve dhe informacionit të marrë në takimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në tërësi lëndët e ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, e aftësojnë studentin të përgatitet për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e programit të studimit. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” përmban të gjithë elementët e nevojshëm të strukturës së një program studimi sipas kuadrit rregullator në fuqi si kurrikula dhe plani mësimor, programet e lëndëve (syllabuset), si dhe rregulloren e programit të studimit. Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41:</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 32 ECTS zënë rreth 18% të krediteve (brenda kufijve ligjorë 15% - 20% të krediteve); ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 93 ECTS zënë rreth 52% të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve); ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 25 ECTS zënë rreth 14% të krediteve (brenda kufijve 12% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 24 ECTS zënë rreth 13% të krediteve (brenda kufijve 10% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 6 ECTS zënë 3% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve). <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është përllogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore</p>

	<p>dhe veprimtari të tjera formuese praktike brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. GVJ vlerëson se përfshirja e lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>GVJ sugjeron rishikimin e rregullores së programit të studimit pasi në disa pjesë të saj përcaktimet janë të përgjithshme, jo të qarta dhe/ose përmbajnë gabime, të cilat lënë hapësirë për interpretime të dyfishta apo kontradiktore (psh paragrafët 2-5 të nenit 6 dhe paragrafët 2-3 të nenit 7).</i></p> <p><i>[Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacioni shoqërues, si dhe informacionet e marra në takimet gjatë vizitës, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjës për programin e studimit përmbushin detyrimet për organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (FSHESH) të KUW. Ky fakultet sëbashku me Fakultetin e Drejtësisë janë dy njësitë kryesore të KUW, rezultat i riorganizimit të ish – Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” të miratuar me UMASH nr.412 të vitit 2011.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse e këtij programi studimi është Departamenti i Ekonomisë, që sëbashku me Departamentin e Psikologjisë dhe Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë përbëjnë njësitë bazë të zhvillimit të</p>

	<p>mësimdhënies dhe të punës kërkimore dhe shkencore në FSHESH.</p> <p>Institucioni ka marrë akreditimin e parë institucional nga ASCAL në vitin 2015 dhe është riakredituar me Vendimin nr. 103 të vitit 2018 nga Bordi i Akreditimit nën emërtimin Kolegji Universitar Wisdom. Programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është akredituar për herë të parë me Vendimin nr.72 të Bordit të Akreditimit më 27.10.2018 për një kohëzgjatje akademike 4 vite, me rekomandime për t'u plotësuar nga institucioni. [Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.02.1 Vendim nr. 72 I KA TE ASCAL.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se me vendimin nr. 435 të datës 4.10.2021 përgjegjësja e Departamentit të Ekonomisë ka emëruar Koordinatorin edhe për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”. Bashkëlidhur vendimit janë edhe detyrat specifike që realizon ky rol duke filluar që nga mbikëqyrja e zhvillimit të programit të studimit, komunikimi i vijueshëm me studentët për të gjitha problematikat e lidhura me realizimin e programit, koordinimi me pedagogët dhe verifikimi i syllabuseve përkatëse deri tek raportimi në mbledhjet e departamentit lidhur me ecurinë e programit të studimit.</p> <p><i>Gjithashtu GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUW (Statuti, Rregullorja e KUW) nuk parashikon rolin e koordinatorit të programit të studimit në mënyrë specifike, por nisur nga referenca e vendosur në vendimin e emërimit, ky rol aktualisht përfshihet në detyrat e parashikuara për përgjegjësin e grupit mësimor e kërkimor.</i></p> <p>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.13 Vendim për kordinatorin e programit.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në Financë-Bankë” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë pranë FSHESH. Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015 (neni 23) Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore (FSHESH) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Ekonomisë; ▪ Departamenti i Psikologjisë; dhe ▪ Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e</p>	

kualifikimit të personelit akademik.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 pranë FSHESH janë angazhuar 24 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë.

Shpërndarja e personelit akademik sipas njësive bazë të FSHESH për vitin akademik 2021-2022 paraqitet si vijon:

- Departamenti i Ekonomisë me 10 pedagogë efektivë nga të cilët 6 me tituj/grada;
- Departamenti i Psikologjisë me 7 pedagogë efektivë nga të cilët 4 me tituj/grada;
- Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë me 7 pedagogë efektivë nga të cilët 3 me tituj/grada.

Struktura e FSHESH dhe e Departamentit të Ekonomisë, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tyre përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e KUW, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi. Rregullorja e FSHESH dhe Rregullorja e Departamentit të Ekonomisë rregullojnë organizimin dhe strukturën e njësive përkatëse bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në Statutin dhe Rregulloren e KUW.

GVJ konstaton se pedagogët e angazhuar pranë Departamentit të Ekonomisë plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Personeli Akademik i Departamentit të Ekonomisë për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:

PAE /Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Profesor	1	1	1
Profesor i Asociuar	1	1	1
Doktor/Docent	2	4	4
Msc.	4	3	4

Gjatë periudhës 2019 – 2021, programi i studimit është realizuar në masën 80% - 92 % me personel akademik efektiv (PAE).

Në këtë program për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar 15 pedagogë si personel akademik (PAE & PAK), ku 3 janë të kategorisë Profesor, 5 janë të kategorisë Lektor dhe mbajnë

	gradën Doktor, ndërsa 7 pedagogët e tjerë të kategorisë As.Lektor janë në vazhdim të kualifikimeve të mëtejshme. <i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e de.pdf; 2.21 Te dhena tab personel akademik.pdf; 2.22.1 Cv e stafit akademik te prog & ndihmes.pdf; Informacion shtese.pdf; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se FSHESH dhe Departamenti i Ekonomisë, që janë përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, disponojnë informacionin e duhur për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ vlerëson se programi i studimit organizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, në lëndë e module, praktikë e aktivitete formuese ku secila vlerësohet me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Ky program, i takon ciklit të parë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në 6 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 180 kredite. Kurrikula e programit të studimit përmban 24 lëndë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe detyrimet përmblylëse (punim diplome ose provim përfundimtar).
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e	Klasifikimi i lëndëve/moduleve dhe vlerësimi i tyre me kredite është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.41: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 32 ECTS zënë rreth 18% të krediteve (brenda kufijve ligjorë 15% - 20% të krediteve);

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 93 ECTS zënë rreth 52% të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve); ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 25 ECTS zënë rreth 14% të krediteve (brenda kufijve 12% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 24 ECTS zënë rreth 13% të krediteve (brenda kufijve 10% - 15% të krediteve); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 6 ECTS zë 3% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve). <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është përlogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore dhe veprimtari të tjera formuese praktike brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit dhe në programet e lëndëve (syllabuset), përfshihet edhe informacioni lidhur me rregullat e frekuentimit/ndjekjes së programit të studimit (i detyrueshëm në masën 50% të orëve teorike dhe praktike), mënyrën e vlerësimit të njohurive nga studentët, metodat e mësimdhënies etj. GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte përgjithësisht i harmonizuar sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 30% të vlerësimit nga frekuentimi, aktivizimi dhe kontrollat e vijueshme (teste/detyra kursi); ▪ 70% të vlerësimit me provim me shkrim në fund të semestrit. <p><i>Por GVJ vëren se kërkesa në rregulloren e programit të studimit lidhur me frekuentimin nuk përkon me kërkesat respektive në kuadrin tjetër rregullator të KUV (p.sh. neni 78 i Rregullores KUV).</i></p> <p><i>[Referenca: 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme</p>	<p>Pranë Departamentit të Ekonomisë, bazuar në vendimarrjen e strukturave përkatëse (Senati i KUV dhe Dekanati i FSHESH), si dhe në Rregulloren e programit të studimit</p>

<p>për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët lidhur me kriteret e pranimit dhe mbarëvajtjes së studimeve. Rregullorja parashikon konkurrimin e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit nëse numri i kërkesave është më i madh se kutotat e pranimit, por GVJ konstaton se në tre vitet e fundit numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi ka qenë shumë i vogël.</p> <p>Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, parashikohen në Rregulloren e Transferimit të FSHESH.</p> <p>GVJ vlerëson se pranimi i studentëve në këtë program studimi realizohet në pajtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, por konstaton se ka një mospërputhje mes kritereve për transferim pranë këtij programi të studentëve nga IAL të tjera dhe kritereve për avancim në vitet pasuese të studentëve të vetë institucionit. Konkretisht nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se studentët mund të transferoheshin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në vitin e dytë në KUW duke patur të paktën 20 kredite (<i>neni 57 i Rregullores së KUW dhe neni 21 I Rregullores së DE</i>), ndërkohë që studentët ekzistues në KUW mund të kalonin në vitin e dytë nëse grumbullonin të paktën 30 kredite. Ky rregull vendos në pozita të disfavorshme studentët ekzistues në krahasim me studentët që transferohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p><i>GVJ sugjeron rishikimin e e kuadrit rregullator të KUW për të harmonizuar kërkesat lidhur me transferimin dhe përparimin e studentëve nga një vit akademik në tjetrin për të mos lënë hapësirë për interpretime të dyfishta.</i></p> <p><i>[Referenca: 1.02 Rregullore e KUW; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB; 2.37 Rregullore transferimeve.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit dhe programet e çdo lënde (syllabuset) janë hartuar në bazë të kërkesave dhe formatit të akteve ligjore dhe nënligjore. Ato përmbajnë informacionin e domosdoshëm për zhvillimin e një lënde: ngarkesën mësimore, semestrin kur zhvillohet, konceptet themelore të lëndës, temat që zhvillohen çdo javë, rregullat e frekuentimit dhe vlerësimit të dijeve në lëndë, literaturën bazë dhe atë ndihmëse etj. Por GVJ vëren gjithashtu se në disa syllabuse ka përsëritje të temave të zhvilluara në lëndët e tjera të këtij programi studimi psh në syllabusin e lëndës “Drejtimit Financiar” (tema e vlerës në kohë të parasë), si dhe në rastin e syllabusit të lëndës “Praktika mësimore” përmbajtja e temave dhe objektivat përkatës i takojnë fushës së Menaxhimit.</p>

	<p><i>GVJ rekomandon rishikimin e këtyre syllabuseve me qëllim eliminimin e përsëritjeve në tema dhe strukturimin e “Praktikës mësimore” në funksion të misionit dhe objektivave të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë”.</i></p> <p><i>[Referenca: 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, në mbledhjen e Departamentit të Ekonomisë diskutohet mbi syllabuset e programit të studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e tyre, nën dritën edhe të problematikave të ndeshura gjatë mësimdhënies por edhe si një proces i vazhdueshëm dhe që ndikon në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Përfundimet lidhur me këto diskutime bëhen pjesë e dokumentit të analizës vjetore të përgatitur nga Përgjegjësjat e Departamentit. GVJ konstatoi se ndryshimet e fundit në këtë program studimi i takojnë vitit akademik 2018-2019, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga BA (ASCAL) në vendimin për akreditimin për herë të parë të këtij programi.</p> <p><i>[Referenca: 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është strukturuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 (neni 73) me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 180 kredite (ECTS). GVJ vlerëson se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, përfshirja e lëndëve në secilën kategori, praktika profesionale, si dhe përmbyllja e programit të studimit me një temë diplome apo një provim përfundimtar u mundësojnë studentëve thellimin e njohurive dhe aftësive të tyre në fushën e financës</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë,</p>	

<p>njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>dhe të sektorit bankar, duke i përgatitur për punësimin si pranë sektorit publik, ashtu edhe atij privat.</p> <p>[Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon 24 lëndë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje të shpërndara në 6 semestra, nga 2 semestra për çdo vit akademik si dhe praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse (punim diplome ose provim përfundimtar). Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Shpërndarja sipas semestrave dhe vlerësimi në kredite i lëndëve mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e financës dhe të sektorit bankar.</p> <p>[Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vlerëson se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor në fushën e financës dhe të sektorit bankar dhe e ngjashme me programe të të njëjtit profil në nivel kombëtar e më gjerë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teori (leksione) 1'143 orë; ▪ Praktikë (seminare/laboratore/praktike profesionale) 822 orë; ▪ Raporti Teori / Praktikë është 1 / 4. <p>Njohuritë e ofruara në këtë program studimi janë të mjaftueshme për të formuar një specialist të fushës përse i takon njohurive të parashikuara në nivelin e studimeve Bachelor.</p> <p>[Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB bachelor finance-banke.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ndarja e lëndëve në këtë program studimi është bërë sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe në funksion të formimit teorik dhe praktik të studentëve. Objektivat formuese të secilës lëndë janë</p>

<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. Ndërkohë pedagogët gjatë procesit të mësimdhënies ilustrojnë me shembuj praktikë njohuritë teorike, për një proces sa më interaktiv dhe efikas në arritjen e objektivave formues.</p> <p>Rregullorja e transferimeve të FSHESH parashikon të gjithë procesin, kriteret dhe procedurat lidhur me transferimin e studimeve. Por siç u përmend edhe më lart, në kriterin 5 të Standardit II.3, <i>GVJ sugjeron rishikimin e rregullores së programit të studimit dhe rregullores së transferimeve për të harmonizuar kërkesat lidhur me transferimin dhe përparimin e studentëve nga një vit akademik në tjetrin (sipas Satutit të KUW) për të mos lënë hapësirë për interpretime të dyfishta.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.37 Rregullore transferimeve.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se përditësimet dhe ndryshimet në programet lëndore miratohen çdo fillim viti akademik, në mbledhjen e Departamentit të Ekonomisë me qëllim për të reflektuar sa më mirë problematikat e ndeshura në vitin e mëparshëm, ndryshimet në mjedisin ekonomik, kërkesat e reja të kuadrit rregullator, si dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar është pjesë e syllabusit të çdo lënde të programit mësimor. Gjatë vizitës në intitucion, GVJ konstatoi angazhimin e personelit akademik për t'u ofruar studentëve informacion sa më aktual dhe praktik, pavarësisht se literatura në programet e lëndëve nuk ishte gjithmonë e pesë viteve të fundit. <i>[Referenca: 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, si dhe syllabuset përkatës u ofrojnë studentëve mundësinë e përfitimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave që nevojiten për një program studimi të ciklit të parë - niveli Bachelor. GVJ vlerëson se përmbajtja e këtij programi studimi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në nivelin Master apo vijimin e kualifikimeve të tjera për marrjen e titujve profesionalë në fushën e financës dhe sektorit bankar.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Hapja së shpejti e programit “Master Shkencor në Financë-Bankë” pranë KUW, do t'u mundësojë studentëve vijimin e kualifikimit të mëtejshëm pranë këtij institucioni ndërkohë që kurrikula e programit u mundëson studentëve të vazhdojnë</p>

	<p>studimet Master edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të tilla.</p> <p>[Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron.</p> <p>Që prej vitit 2019, pranë KUW është krijuar Bordi Këshillmor i Biznesit me përfaqësues nga tregu i punës me objektiv parësor bashkëpunimin me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit të ofruara apo të reja në KUW. Relacioni i takimeve të Bordit bëhet pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p>[Referenca: 2.25 Vendim bordi i biznesit.pdf; 2.25.1 Relaciom mbledhja e bordit biznesit.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” përmbush kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2021-2022, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 15 pedagogë nga të cilët 12 anëtarë të personelit akademik (PAE) dhe 3 personel akademik me kontratë (PAK).</p>

	<p>[Referenca: 2.22.1 CV e stafit akademik te prog & ndihmes.pdf; Informacion shtesë: Lista e pedagogeve FB.pdf; Te dhena tabelore per personelin akademik.pdf; Rregullore dept BNJ.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mësimdhënien dhe mbulimin e të gjitha aktiviteteve bashkëshoqëruese të një programi studimi Bachelor.</p> <p>Numri dhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitet 2019 – 2022 paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar gjithsej 11 pedagogë, nga të cilët 9 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë (PAE): <ul style="list-style-type: none"> 1 Profesor 1 Profesor i Asociuar 4 Doktor i Shkencave 3 Msc <p>Personel akademik me kontratë janë dy pedagogë, njëri mban titullin Profesor i Asociuar dhe tjetri mban kualifikimin Msc.</p> <p>Raporti është 82% PAE dhe 18% PAK.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar gjithsej 13 pedagogë, nga të cilët 12 pedagogë si personel akademik PAE: <ul style="list-style-type: none"> 1 Profesor 1 Profesor i Asociuar 6 Doktor i Shkencave 4 Msc <p>Personeli akademik me kontratë mban titullin Profesor i Asociuar.</p> <p>Raporti është 92% PAE dhe 8% PAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar gjithsej 15 pedagogë, nga të cilët 12 pedagogë si personel akademik PAE: <ul style="list-style-type: none"> 1 Profesor 1 Profesor i Asociuar 4 Doktor i Shkencave 6 Msc

	<p>Personel akademik me kontratë janë tre pedagogë, nga për secilën kategori Profesor i Asociuar, Doktor dhe Msc.</p> <p>Raporti është 80% PAE dhe 20% PAK.</p> <p>GVJ konstatoi se personeli akademik merr pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe angazhohet në botimin e artikujve kërkimorë në revista shkencore, duke rritur kualifikimin e tij shkencor. Fusha akademike-shkencore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” përputhet me lëndët që ata mbulojnë në këtë program.</p> <p><i>[Referenca: 2.22 Format i dosjes personale.pdf; 2.22.1 Cv e stafit akademik te prog & ndihmes.pdf; Informacion shtesë: Lista e pedagoqeve FB.pdf; 2.21.2 Te dhena tabelore per personelin akademik.pdf; Rregullore dept BNJ.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, një pjesë e të cilave janë në funksion të realizimit të praktikës profesionale 5-javore të parashikuar në semestrin e 6-të të këtij programi studimi. Për mbarëvajtjen e suksesshme të praktikës, në përputhje me rregulloren përkatëse Përgjegjësja e Departamentit të Ekonomisë përcakton dhe pedagogët mbikëqyrës sipas grupeve të studentëve të programit të studimit. Gjithashtu GVJ konstaton se programi i studimeve parashikon realizimin e diplomës për studentët me mesatare të lartë dhe përcaktimin e një pedagogu si udhëheqës i punimit të diplomës së studentit. <i>[Referenca: 3.11 Vendim per mbikqyrjen e praktikës.pdf; 3.12 Udhezues per praktikat bachelor.pdf; 3.12.1 Rregullore per pergatitje e temave te diplomes bachelor.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Pranë KUW personeli ndihmës mësimor dhe administrativ është në funksion të të gjitha programeve të studimit të institucionit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi angazhimin e personelit ndihmës në funksion të këtij programi studimi.</p> <p><i>Por GVJ rekomandon se duhet të rritet numri i personelit ndihmës mësimor të dedikuar sipas cikleve apo programeve të studimit për të garantuar një angazhim efektiv në funksion edhe të rritjes së numrit të studentëve dhe programeve të studimit pranë KUW.</i></p>




	[Referenca: Te dhena tabelore per personelin akademik.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacion shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se K UW në dokumentacionin e tij rregullator ka parashikuar format e organizimit të procesit mësimor duke përfshirë udhëzues mbi elementët e mësimdhënies në auditor dhe jashtë auditorit (leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktika profesionale, punimi i diplomës etj). Në mënyrë periodike pranë K UW organizohen workshop-e dhe trajnime me pedagogët për kualifikimin e mëtjshëm të tyre apo përditësimin me zhvillimet e reja në lidhje me metodat e ndryshme të mësimdhënies. [Referenca: 1.02 Rregullore K UW.pdf; 2.06 Rregullore e FS HESH.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Gjithashtu GVJ konstatoi se në K UW, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin periodik të mësimdhënies është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në bashkëpunim me Dekanatin e FS HESH dhe Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë. NJSBC bazuar në planin e miratuar të veprimtarisë për vitin akademik dhe në bashkëpunim me grupet përkatëse të punës pranë K UW

	<p>realizon, si pjesë e punës monitoruese dhe vlerësuese, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pyetësorët e studentëve nëpërmjet të cilëve përfitohet informacion mbi cilësinë e programit të lëndëve, zhvillimit të procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies nga pedagogu dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të studentit; ▪ Pyetësorët që plotësohen nga pedagogët, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi metodologjinë didaktike, marrëdhëniet me institucionin dhe kolegët, aksesin në trajnime dhe konferenca për monitorimin e kërkimit të tyre shkencor; ▪ Kontrollë të procesit mësimor sipas kalendarit semestral dhe sipas cikleve të studimit; ▪ Intervistat informale me studentët dhe takime të përbashkëta me studentë dhe pedagogë të KUW, në fund të çdo semestri, me objekt ecurinë dhe problematikat e ndeshura gjatë mësimdhënies; <p>Pas përpunimit të rezultateve të pyetësorëve dhe aktiviteteve të tjera monitoruese NJSBC përgatit relacionin përkatës për titullarët e institucionit.</p> <p><i>[Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.06 Rregullore NJSBC.pdf; 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilesise.pdf; 2.19.6 Relacion kalendarit e kontrollit.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.36 Model vleresimi i performances stafit akademik.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij program studimi, GVJ mori konfirmimin se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimin të dijeve nëpërmjet plotësimin të pyetësorit në fund të çdo semestri. Gjithashtu koordinatori i programit të studimit dhe sekretaria mësimore shërbejnë si pika të kontaktit të vazhdueshëm me studentët për ecurinë, problematikat (përfshirë ankimimet) në lidhje me procesin e mësimdhënies, si dhe raportimin e këtyre pranë Departamentit të Ekonomisë. <i>[Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.13 Vendim per kordinatorin e programit.pdf; 2.19.3 Model pyetesori i studenteve.pdf; Relacion Pyetesori Studenteve.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se NJSBC pasi përpunon rezultatet e vlerësimeve përmes pyetësorëve, të kontrolleve sipas kalendarit apo dhe të takimeve të zhvilluara, harton relacionet përkatëse të cilat u komunikohen autoriteteve drejtuese të KUW, përkatësisht Senatit</p>

	<p>Akademik, Dekanit të FSHESH dhe Përgjegjëses së Departamentit të Ekonomisë. Anëtarët e personelit akademik informohen nga Përgjegjësjë në mbledhjet e Departamentit dhe përmes raportit vjetor të veprimtarisë së Departamentit. Gjithashtu raporti vjetor i NJSBC publikohet edhe në faqen zyrtare në internet të KUW. [Referenca: 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilësisë.pdf; 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; https://wisdom.edu.al/njsbc; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacione e paraqitur në RVB dhe informacione e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e KUW dhe të Departamentit të Ekonomisë në përdorimin e analizave periodike e punës, në nxitjen dhe promovimin e shembujve të praktikave të mira në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të programeve të studimit. [Referenca: 2.07 Analiza vjetore e fshesh.pdf; 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues rezultoi se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi janë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, detyrat e kursit dhe praktika profesionale. Gjithashtu konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e leksioneve të hapura me specialistë të fushës. Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” parashikon realizimin gjatë 3 viteve akademike të 4'500 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1'143 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 651 orë mësimore në auditor seminare & ushtrime; ▪ 15 orë mësimore laboratorë; ▪ 300 orë praktikë & diploma; ▪ 2'391 orë të tjera punë individuale jashtë auditorit.

	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se laboratorët përdoren për realizimin e dy lëndëve: “Informatikë” dhe “Paraja dhe Banka”. që zhvillohen gjatë vitit të tretë akademik.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde është i përfshirë informacioni në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve. Në syllabus është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të studentëve me pikë dhe notë (vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi final), si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës. [Referenca: 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe pa dallime diskriminuese, për të gjithë studentët në arritjen e objektivave të tyre akademike. Në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, duke integruar teknologjinë në mësimdhënie dhe duke nxitur përfshirjen aktive të studentëve përmes projekteve dhe detyrave të kursit, punës në grup për të nxitur diskutimet dhe bashkëpunimin sipas roleve, si dhe për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reagimeve dhe opinioneve të studentëve. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e KUW në mbështetjen e personelit akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike përmes organizimit të trainimeve dhe leksioneve të hapura për personelin akademik në institucion, mbështetjes me fonde të veçanta për pjesëmarrje në organizime (trajtime, workshop, konferenca) jashtë institucionit si dhe përmes sigurimit të software-ve dhe platformave on-line në ndihmë të organizimit të mësimin dhe kërkimit shkencor. [Referenca: 2.35 Vendim i administratores per veprimtarine kerkimore shkencore.pdf; 3.09 Vendim D.E. per materialet didaktike.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe jetëshkrimeve të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” përmbush kërkesat ligjore në fuqi për mësimdhënie në ciklin</p>



mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	e parë të studimeve pasi ka kualifikimin dhe kompetencat e duhura për shpjegimin e njohurive.			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi se nxit studentët gjatë orëve të mësimit të përfshihen sa më shumë edhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, duke ofruar sugjerime në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit kryesisht përmes pyetësorëve të studentëve, por jo vetëm. Rezultatet e analizës së pyetësorëve të studentëve, në fund të çdo semestri, janë pjesë e analizave që realizojnë në mënyrë periodike të gjitha strukturat mësimdhënëse dhe drejtuese të KUW, me qëllim përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në institucion. [Referenca: 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; 2.22.1 CV e stafit akademik te prog & ndihmes.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi se në procesin mësimor përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore. Fokusi kryesor ishte përfshirja aktive e studentëve në diskutime praktike, objektive dhe me sens kritik gjatë orëve të leksioneve dhe të seminareve.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Studenti, që në fillim të zhvillimit të lëndës, njihet me mënyrën e vlerësimit të dijeve të tij, pikët për pjesën e vlerësimit të vazhduar dhe pikët dhe notën për vlerësimin final, si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes personelit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit fb.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në	

hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.

Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacion shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” zhvillon aktivitetet mësimore në godinën e marrë me qira nga KUW në Autostradën Tiranë-Durrës. Ambientet janë të mjaftueshme, si numër dhe si sipërfaqe, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar leksionet, seminarët, laboratorët etj, si dhe për t’u garantuar studentëve dhe pedagogëve kushte sa më të përshtatshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Ambientet ku zhvillohet mësimi janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht nga personeli i sektorit të shërbimeve.

Të dhënat në vijim i referohen përmblendhtas mjediseve kryesore në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik pranë KUW:

MJEDISI	NR. SALLAVE
Salla leksioni	10
Salla seminari	10
Laborator informatike/lëndësh	2
Zyra për personelin akademik	5
Bibliotekë / Internet	2
Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	7

Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi.

[Referenca: 2.28 Planimetria&infrastruktura.pdf; 2.29 Kontrate qeraje.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.

Gjithashtu, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi studimi në funksion të realizimit të procesit mësimor, shfrytëzojnë:

- Sistemin e komunikimit të brendshëm të KUW me hyrje të dedikuara për të gjithë përdoruesit (studentë dhe pedagogë). Në hapësirat përkatëse përdoruesit gjejnë informacionin e nevojshëm për realizimin e procesit

	<p>mësimor si programi i lëndëve, oraret, materialet e vendosura nga pedagogu, vlerësimet si dhe njoftime të ndryshme lidhur me programin e studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ambientet e pajisura me sistemin wi-fi për të lehtësuar komunikimin mes përdoruesve. ▪ Laboratorin e kompjuterave ku zhvillohen orët e lëndëve “Informatikë” dhe “Paraja dhe Banka” të këtij programi studimi, por që u vjen në ndihmë edhe për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit apo temave të diplomës. <p>Për mbarëvajtjen sa më efektive të infrastrukturës teknologjike, KUW ka hartuar edhe “Udhëzuesin për Monitorimin e Strukturës së TI”. [Referenca: 1.17 Udhëzues për monitorimin e strukturës së TI KUW.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në programet e lëndëve GVJ konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse të këtij programi përmbushin objektivat e studimit të tij dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</p> <p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, kryesisht të autorëve shqiptarë, por edhe përkthime në shqip të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në informacionin shoqëruar të RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ofron literaturë të shumëllojshme për programet e studimit që ofron KUW dhe hapësirë të mjaftueshme për studentët e këtij programi studimi. Fondi i librave në bibliotekë përbëhet nga tekste mësimore, periodikë, revista e buletine shkencore, fjalorë, teza diplomash etj. Për programet e Departamentit të Ekonomisë, biblioteka disponon rreth 270 tituj libra fizikë. Gjithashtu, biblioteka dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit. Përveç vënies në dispozicion të studentëve dhe personelit të fondit fizik të librave, periodikëve, revistave etj në gjuhën shqipe dhe të huaj, KUW ka lidhur marrëveshje për shfrytëzimin e platformave online të bibliotekave si “ProQuest” dhe “COBISS”. Studentët dhe personeli i KUW mund të përdorin shërbimet e bibliotekës falas, përkundrajt anëtarësismit, në intervalin 8.30-19.30 nga dita e hënë deri në ditën e premte.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	

	<i>[Referenca: 2.20 Relacion biblioteka.pdf; 2.20.1 Propozim per blerje librash.pdf; 2.38 Evidence kerkimi shkencor.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi për realizimin e laboratorëve, detyrave/projekteve të kursit, diplomave dhe dokumentacionit të praktikës, shërben laborator i “Informatikës” por edhe ambientet e bibliotekës të cilat shfrytëzoheshin rregullisht prej tyre. <i>[Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi studimi përdorin “Sistemin e komunikimit të brendshëm” të KUW me hyrje të dedikuar për të gjithë përdoruesit (studentë dhe pedagogë), si platformë online komunikimi në funksion të realizimit të procesit mësimor. Në hapësirat përkatëse përdoruesit gjejnë informacionin e nevojshëm për realizimin e procesit mësimor si programi i lendëve, oraret, materialet e vendosura nga pedagogu (leksione, detyra, raste studimore), vlerësimet si dhe njoftime të ndryshme të lidhura me programin e studimit. Për mbarëvajtjen sa më efektive të infrastrukturës teknologjike, KUW ka hartuar edhe “Udhëzuesin për Monitorimin e Strukturës së TI”. <i>[Referenca: 1.17 Udhëzues per monitorimin e struktures se TI KUW.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Rregullorja e njësisë bazë (neni 26) dhe Rregullorja e programit të studimit (neni 15), parashikojnë mundësinë për përgatitjen e temës së diplomës bachelor, për studentët që kanë marrë 174 kredite gjatë 3 viteve të studimit dhe kanë një nivel cilësor mesatareje të përgjithshme (jo e specifikuar në këto rregullore). Gjatë përgatitjes së temës së diplomës studenti udhëhiqet nga një personel akademik të cilin mund ta ketë propozuar edhe vetë, por që duhet të miratohet nga Departamenti. KUW ka përgatitur edhe një dokument specifik “Rregulloren për përgatitjen e temës së diplomës bachelor”, për të udhëzuar studentët që ndërmarrin përgatitjen e një teme diplome për një punim sa më cilësor. <i>Megjithatë, GVJ konstatoi disa mospërputhje përsa i takon kërkesave në rregulloren e këtij programi studimi lidhur me argumentin temë diplome, kundrejt pjesës tjetër të kuadrit</i>

	<p><i>rregullator të KUW, prandaj rekomandon rishikimin dhe harmonizimin e kërkesave në kuadrin rregullator edhe për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.12.1 Rregullore per pergatitje te diplomes bachelor.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, Statutin dhe Rregulloren e KUW, GVJ vlerëson se në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar stuktura të posaçme që promovojnë dhe monitorojnë përmirësimin e cilësisë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; ▪ Komisionet e Përherëshme: <ul style="list-style-type: none"> ○ Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë; ○ Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulën; ○ Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët, Publikun dhe Koordinimin. <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), strukturë autonome e përhershme pranë KUW, përbëhet nga 5 anëtarë të propozuar nga njësitë kryesore (një anëtar nga këshilli studentor) dhe të miratuar nga Senati i KUW. NJSBC vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. NJSBC bashkëpunon me personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të institucionit.</p>

	<p>Komisionet e përhershme janë të organizuar me nga 5 anëtarë, të vetëkandiduar dhe të miratuar nga Senati i KUW me mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhje.</p> <p>Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë mbikëqyr veprimtarinë lidhur me garantimin e standardeve të cilësisë në institucion dhe këshillon strukturat e KUW lidhur me to.</p> <p>Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët, Publikun dhe Koordinimin mbikëqyr veprimtarinë lidhur me këshillimin dhe koordinimin e marrëdhënieve me studentët dhe publikun, në përputhje me misionin, vizionin dhe politikat e KUW.</p> <p>Komisioni për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulën ka për detyrë kryesore mbikëqyrjen, promovimin dhe orientimin drejt përmirësimit dhe ndryshimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit pranë KUW.</p> <p>Komisionet e përhershme, gjithashtu bashkëpunojnë me personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të institucionit.</p> <p><i>GVJ vëren një mbivendosje të figurave në strukturat e komisioneve dhe NJSBC të KUW. Megjithëse kjo mbivendosje mund të justifikohet aktualisht me madhësinë e kufizuar të programeve të KUW (në numër studentësh) mund të sjellë problematika në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi apo të lidhura me konfliktin e interesave, prandaj rekomandojmë plotësimin e këtyre strukturave me burime njerëzore të dedikuara për të rritur efikasitetin dhe punën e tyre jo vetëm de jure por edhe de facto.</i></p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.10 Rreg. komisionit për studentet publikun & kordinimin.pdf; 1.11 Rreg.e komisionit për garantimin e cilesise.pdf; 1.12 Rreg.e komisionit për veprimtarise & kurrikulen.pdf; 2.06 Rreg. e FSHESH.pdf; 2.27 Vendim për komisionet e perhereshme.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatin e FSHESH kanë si fokus kryesor rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e këtij programi. Në punën e tyre, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, ata mbështeteten edhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Komisionet e Përhershme pranë KUW.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin</p>	

<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ vlerëson se pedagogët e departamentit janë të angazhuar në përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve të këtij programi, si dhe teknikave dhe metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu, analiza e punës vjetore të departamentit është në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit. Duke iu referuar takimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW nxit dhe mbështet personelin akademik që në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme të aplikojë për mobilitete dhe trajnime, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sipas kërkesave bashkëkohore. [Referenca: 1.03 Plani strategjik KUW.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; 4.01 Raport Vjetor NJSKSHMJ.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik është i angazhuar për kualifikimin e vijueshëm përmes pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve në revista shkencore vendase dhe të huaja, si dhe përfshirjes në projekte të ndryshme rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka lidhur KUW.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjithashtu institucioni ka organizuar trajnime dhe workshop-e të ndryshme për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të personelit akademik nëpërmjet zbatimit të metodave inovative të mësimdhënies. [Referenca: 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; 4.01.1 Raport per perfuimet e MB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUW, përfshirë rregulloren e FSHESH dhe të Departamentit të Ekonomisë, parashikon qartë detyrat e personelit akademik dhe ndihmësakademik për realizimin e programeve të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë e ofruara nga institucioni për realizimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Gjithashtu GVJ konstatoi se personeli akademik raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e tyre përmes relacioneve semestrale sipas lëndëve që mbulojnë, por edhe përmes formularëve të vlerësimit (të kapaciteteve dhe të performancës). Ky informacion i përpunuar më pas nga strukturat përkatëse në formën e raporteve në nivel departamenti, fakulteti dhe KUW, bëhet</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për</p>	<p>të reja të mësimdhënies. Gjithashtu GVJ konstatoi se personeli akademik raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e tyre përmes relacioneve semestrale sipas lëndëve që mbulojnë, por edhe përmes formularëve të vlerësimit (të kapaciteteve dhe të performancës). Ky informacion i përpunuar më pas nga strukturat përkatëse në formën e raporteve në nivel departamenti, fakulteti dhe KUW, bëhet</p>

rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	pjesë e analizës vjetore të departamentit, ku mes të tjerash diskutohen efektet dhe problematikat e ndeshura gjatë përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies. [Referenca: 2.12 Analize vjetore e DE.pdf; 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.36 Model vlerësimi i performances stafit akademik.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUW, si Rregullorja e institucionit, Rregullorja e FSHESH, Rregullorja e Departamentit të Ekonomisë dhe Rregullorja e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, përcakton të gjitha kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të marra nga studentët gjatë ciklit të studimeve. Gjithashtu, mënyrat e kontrollit të dijeve dhe të vlerësimit përcaktohen edhe në syllabusin e çdo lënde dhe u bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës. Në faqen zyrtare në internet të institucionit gjenden të publikuara Rregullorja dhe Statuti i KUW, si dhe në mënyrë të fokusuar pjesë nga Rregullorja e KUW që lidhet me sistemin e vlerësimit të studentëve (neni 92). [Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rreg. prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; https://wisdom.edu.al/sistemi-vleresimit-studenteve]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët, që në fillim të semestrit, njihen me të gjithë elementët e programit mësimor (syllabusit) përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu ky informacion publikohet edhe në hapësirën përkatëse të sistemit të brendshëm të komunikimit të KUW, ku studentët mund ta konsultojnë përmes hyrjeve të

	dedikuara. [Referenca: 3.10 Programe mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Kuatrri rregullator parashikon si forma të kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë aktivitetit mësimor testimin e ndërmjetëm, detyrat dhe projektet e kursit, prezantimet, provimin e lëndës (me shkrim dhe /ose me gojë), praktikën dhe temën e diplomës. Nga shqyrtimi i programeve mësimore (syllabuseve), GVJ krijoi bindjen se vlerësimi i studentëve realizohej në bazë të formave të parashikuara në kuadrin rregullator, duke u dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të KUW. Konkretisht vlerësimi final rezulton përgjithësisht i harmonizuar mes lëndëve (me përjashtim të dy lëndëve) dhe përcaktohet në masën: <ul style="list-style-type: none"> ▪ 30% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera të vijueshme si teste, raste studimore, detyra dhe projekte kursi; ▪ 70% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit. <p>[Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit fb.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronik të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme	GVJ nuk konstatoi përdorimin e ndonjë sistemi elektronik testimi në funksion të këtij programi studimi përveç përdorimit të platformave “Google Classroom & Meet” dhe


abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>“Microsoft Teams” kryesisht si rezultat i masave të marra në përgjigje të situatës të krijuar nga pandemia Covid-19.</p> <p>[Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Departamentit, Përgjegjësja e Departamentit të Ekonomisë miraton komisionet dhe tezat e provimit, pas konsultimit me personelin akademik përgjegjës (nenet 5, 10 -- 15). Gjithashtu kjo rregullore parashikon ngritjen e komisionit të provimit me dy anëtarë, pedagogu dhe asistenti që kanë zhvilluar lëndën. [Referenca: 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet me shkrim zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të anonim emrin e studentit në fletën e provimit. Në këtë proces angazhohet edhe sekretaria mësimore dhe Dekanati i FSHESH. Gjithashtu në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në FSHESH, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare, si edhe i testeve të ndërmjetme, i detyrave dhe projekteve të kursit, duke u dhënë studentëve këshilla në funksion të përmirësimit të punës së tyre në të ardhmen. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Në Rregulloren e programit të studimit janë parashikuar edhe masat disiplinore në rastet e konstatimit të sjelljeve të dënueshme si kopjimi në provime, plagjiatura në punime shkencore, shkeljet e rregullores etj. Kërkesat e Kodit të Etikës janë përfshirë edhe në programet mësimore (syllabuset). [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në FSHESH, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare. Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit të studimit parashikojnë një afat komunikimi të rezultateve dhe</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në FSHESH, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare. Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit të studimit parashikojnë një afat komunikimi të rezultateve dhe</p>

kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	të dorëzimit të procesverbaleve të provimit 5-15 ditë nga data e zhvillimit të provimit. GVJ vlerëson se në KUW përdoren instrumenta efektivë për të garantuar rezultate të bazuara mbi meritat e punës së studentit. [Referenca: 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUW, në nenet përkatëse, parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe/ ose vlerësimin në provim, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Përgjegjësës së Departamentit. Ankesa për procesin duhet të paraqitet 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 48 orëve nga komunikimi i rezultateteve të provimit. Përgjegjësja e Departamentit në bashkëpunim me komisionin e provimeve bëjnë verifikimet dhe rishikimin sipas situatës.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në raste të problematikave të veçanta Përgjegjësja e Departamentit vë në dijeni Dekanin e FSHESH i cili brenda 48 orëve nga njoftimi vijon me ngritjen e një komisioni të posaçëm për të bërë verifikimet e nevojshme lidhur me ankesën e studentit. E gjithë praktika e ankimimit, përfshirë komunikimet mes palëve dhe dokumentacionin e shqyrtuar, në përfundim të procesit ruhet në arkivë. [Referenca: 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit "Bachelor në Financë-Bankë" është konceptuar të zhvillohet në 3 vite akademike. Lëndët e përfshira në këtë program u mundësojnë studentëve marrjen e dijeve nga disiplinave të ndryshme si financa, kontabiliteti dhe menaxhimi si dhe të disiplinave të lidhura me to si legjislacioni, informatika etj. Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit konstatohet se veprimtaritë formuese të programit (puna në auditor dhe jashtë tij) janë përcaktuar



	në funksion të formimit të studentëve, në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të tyre. [Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ vlerëson se përfshirja në programin e studimit të lëndëve ndërdisiplinore dhe plotësuese si “Informatika”, “Historia e mendimit ekonomik”, “Shkrimi akademik”, “Gjuha angleze” etj u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. [Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.05 Veprimtari formuese.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se pedagogët e këtij programi studimi në fund të çdo semestri hartojnë një relacion mbi ecurinë dhe problematikat e lëndës së zhvilluar, i cili është dhe objekt analize jo vetëm në Departamentin e Ekonomisë por edhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. [Referenca: 2.19.5 Relacion semestral (template).pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjithashtu, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pranë KUW pedagogët e këtij programi studimi kanë zhvilluar leksione të hapura mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Leksionet e hapura janë jashtë strukturës së programit të studimit por pjesë e veprimtarive të parashikuara për vitin akademik nga Departamenti i Ekonomisë. [Referenca: 2.11 Programi i veprimtarive kryesore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit dhe programeve mësimore (syllabuseve), GVJ konstaton se lënda “Informatikë” u mundëson studentëve që përmes orëve në laborator të zhvillojnë aftësitë në teknologji. Gjithashtu praktika profesionale e parashikuar si detyrim akademik për t’u realizuar në semestrin e gjashtë, u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë profesionale përmes zbatimit në një mjedis profesional real të njohurive teorike të marra në auditor. [Referenca: 3.04 Plane mesimore.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf; 3.11 Vendim për mbikqyrjen e praktikës mesimore.pdf; 3.11.1 Relacion për praktikat e studenteve.pdf]

<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në takimin, gjatë vizitës në institucion, me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, GVJ konstatoi se ata mbështesin diskutimet dhe idetë e studentëve në zgjidhjen e problematikave të caktuara. Programet mësimore (syllabuset), të hartuara dhe zhvilluara prej tyre, nxisin bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes detyrave dhe projekteve të kursit, prezantimeve të ndryshme dhe analizës së rasteve studimore.</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik motivon dhe nxit idetë inovative dhe punën kërkimore dhe shkencore të studentëve përmes bashkëbisedimit, diskutimeve kritike, detyrave e projekteve të kursit dhe praktikës profesionale, brenda kuadrit të këtij program studimi. Në vëmendje të Departamentit të Ekonomisë dhe Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë (NJKSHMJ) është edhe përfshirja e studentëve në projekte dhe aktivitete shkencore si realizimi i konferencës ndërstudentore, pjesëmarrja e tyre në mobilitete studentësh dhe trajnime e workshop-e në kuadër të projekteve Erasmus+ etj. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUW mbështet financiarisht veprimtaritë dhe aktivitetet e Këshillit Studentor dhe vë në shërbim të tyre ambientet e institucionit.</p> <p><i>[Referenca: 1.20 Te dhena per platformat online.pdf; 2.35.1 Administratorja per mbeshtetjen k.studentor.pdf; 2.24.2 Klubet studentore.pdf; 3.09 Vendim D.E. per materialet didaktike.pdf; 3.04 Plane mesimore.pdf; 4.01 Raport Vjetor NJSKSHMJ.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Gjithashtu, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë (NJKSHMJ) pranë FSHESH ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit me institucionet përmes përfshirjes në projekte të ndryshme. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, përfshirë edhe projektet ndërkombëtare janë realizuar trajnime, workshop-e dhe mobilitete të cilat përfshijnë edhe studentët e Departamentit të Ekonomisë. <i>[Referenca: 4.01 Raport Vjetor NJSKSHMJ.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se kuadri rregullator i KUW ka parashikuar një procedurë të plotë për mënyrën e diplomimit të studentëve. Konkretisht diploma e ciklit të studimeve “Bachelor” mbrohet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me temë diplome nëse mesatarja e notave të fituara nga studenti deri në semestrin e pestë përpara diplomimit është mbi nivelin e notës mesatare të përcaktuar në rregulloret e Fakultetit apo Departamentit. Sipas RVB ky kriter aktualisht është 8.5. Rregullorja e KUW është e publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.</p> <p><i>GVJ vëren se edhe për këtë aspekt Rregullorja e Programit të Studimit “Bachelor në Financë-Bankë” duhet të rishikohet dhe përditësohet me kërkesat e kuadrit kryesor rregullator të KUW. [Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se personeli akademik, koordinatori i programit të studimit dhe sekretaria mësimore informojnë studentët mbi të gjithë procesin e diplomimit në ciklin bachelor, me provim përfundimtar ose me temë diplome.</p> <p>Si rregull drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti. dhe përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me pedagogun drejtues. Gjithashtu konstatohet që institucioni ka përgatitur dhe vë në dispozicion të studentëve edhe një Rregullore -Udhëzues për hartimin e temës së diplomës në nivelin bachelor. Brenda një muaji, para fillimit të praktikave profesionale, dekani në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve u bën të njohur studentëve të vitit të fundit temat e diplomave që mund të propozohen nga studentët dhe programin e pyetjeve të provimit të përgjithshëm përfundimtar. [Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 3.12.1 Rregullore per pergatitje te diplomes bachelor.pdf; 3.12.2 Fondi i</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	

	<i>pyetjeve per provimin perfundimtar.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orientojnë dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Në takimet, gjatë vizitës në institucion, me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”, GVJ konstatoi mbështetjen që studentët marrin nga personeli akademik përgjatë gjithë procesit të diplomimit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Biblioteka, laboratorët dhe ambiente të tjera të KUW mund të shfrytëzohen nga studentët për kryerjen e hulumtimeve dhe analizave, përgatitjen e temës dhe prezantimit të diplomës apo dhe për studim të pavarur. Në rastin kur studenti përfundon studimet duke mbrojtur diplomë pedagogu drejtues e udhëzon për strukturën e punimit të diplomës, metodologjinë, e orientojnë për literaturën që ai duhet të hulumtojë në funksion të temës, si dhe i jep këshilla për organizimin e analizës dhe rezultateve deri në përfundimin e punimit. <i>[Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 3.12.1 Rregullore per pergatitje te diplomes bachelor.pdf; 3.12.2 Fondi i pyetjeve per provimin perfundimtar.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni përkatës në përfundim të provimit apo mbrojtjes së diplomës bën vlerësimin e studentit me notë, sipas sistemit 4 - 10 të parashikuar në kuadrin rregullator të KUW. <i>[Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 3.12.1 Rregullore per pergatitje te diplomes bachelor.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstaton se në përfundim të studimeve në programin “Bachelor në Financë-Bankë”, pasi studenti ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj KUW pajiset me diplomën përkatëse, suplementin e diplomës dhe listën e notave sipas modelit të miratuar. Emërtimi dhe suplementi i diplomës janë në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti dhe me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre programi mësimor (syllabuset) për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit. <i>[Referenca: 3.13 Suplementi i diplomes.pdf; 3.14 Modeli i diplomes.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	

<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se pranë sekretarisë mësimore të KUW ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formë e dosjeve personale, edhe pas diplomimit bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky dokumentacion vihet të dispozicion studentit me kërkesën e tij dhe mund të përdoret për konfirmime ndaj personave të autorizuar. [Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.07 Rreg.sekretarise mesimore.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në Rregulloren e KUW (neni 115) dhe Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.</p> <p>Gjatë takimit me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në organizimin e programeve të studimit që ofron ky institucion. Zyra e</p>

	<p>Burimeve Njerëzore plotëson, ruan dhe përditëson dosjet personale të personelit. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, trainimet, librezat shëndetësore etj. [Referenca: 1.02 Rregullore e KUW; Dokument "Rregullore e Dep BNJ"; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rregullorja e KUW (neni 37), përcakton procedurat e rekrutimit dhe angazhimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe personelit akademik të ftuar (neni 41), në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore e nënligjore të arsimit të lartë të Republikës në Shqipërisë dhe Statutin e KUW. [Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore e KUW; Dokument "Rregullore e Dep BNJ"]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, procedurat e rekrutimit të personelit akademik përcaktohen në statutin dhe rregulloren e KUW (nenit 38 dhe 39). Kriteret për rekrutimin e personelit propozohen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga Dekani. Sipas RVB, kriteret e rekrutimit të personelit akademik bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. [Referenca: 1.02 Rregullore e KUW; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; Dokument "Rregullore e Dep BNJ"]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik përcaktohen në Statutin dhe Rregulloren e KUW dhe ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore (ZBNJJKJS). Departamenti, pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik, i paraqet propozimin për rekrutim të personelit akademik Dekanit. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, argumentimin e këtij propozimi, si dhe në varësi të ngarkesës dhe lëndës që pritet të mbulojë. Me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit ngrihet një komision ad-hoc i përbërë nga personeli akademik i departamentit. Kryetar i komisionit është Dekani i cili bën propozimin për emërim dhe punësim të kandidatit fitues. [Referenca: 1.01 Statuti KUW; 2.24.1 Procedurat e rekrutimit; 1.02 Rregullore e KUW; Dokument "Rregullore e Dep BNJ"; vizita në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Jo përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	KUW angazhohet që t'i sigurojë personelit akademik dhe personelit ndihmës kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (salla leksioni, seminari, laboratorë etj) dhe zyra të përshtatshme për kryerjen e detyrave të ndryshme administrative. [Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, si nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, edhe nga takimi me pedagogë të këtij programi studimi, GVJ iu konfirmua angazhimi nga institucioni për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon programin e studimit. Institucioni organizon konferenca dhe ka revistën e tij "Wisdom" ku pedagogët kanë mundësi të marrin pjesë dhe të botojnë punën e tyre shkencore pa pagesë. Gjithashtu, institucioni ka organizuar leksione të hapura dhe ka mundësuar pjesëmarrje të pedagogëve në mobilitete, duke rritur kualifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre didaktike. Informacioni mbi konferencat dhe revistën e institucionit është i aksesueshëm në faqen zyrtare të internetit të institucionit. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; https://wisdom.edu.al/kerkimi-shkencor-dhe-botime ; vizita në institucion]
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të teknologjive të reja për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe kualifikimin shkencor të personelit akademik. Për këtë qëllim Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka zhvilluar workshop-e dhe trajnime me profesorë vendas dhe të huaj, për të cilat është dhënë informacion në RVB dhe janë paraqitur evidenca në dokumentacionin shoqëruar.
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e	Angazhimi i burimeve njerëzore nga institucioni, duke marrë parasysh si kualifikimin shkencor të tij edhe ngarkesën mësimore, bëhet në drejtim të përbushjes së objektivave të programit të studimit. Për këtë program studimi për vitin

objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>akademik 2021-2022 janë angazhuar gjithsej 15 pedagogë, nga të cilët 12 pedagogë si personel akademik PAE:</p> <p>1 pedagog me titullin Profesor;</p> <p>1 pedagog me titullin Profesor i Asociuar;</p> <p>4 pedagogë me gradën Doktor i Shkencave; dhe</p> <p>6 pedagogë me kualifikimin Msc.</p> <p>Personel akademik me kontratë janë 3 (tre) pedagogë, një për secilën prej kategorive Profesor i Asociuar, Doktor dhe Msc.</p> <p>GVJ konstatoi se për shkak të numrit të vogël të studentëve dhe klasave të vogla, pedagogët angazhohen në dhënien e disa lëndëve, fakt i cili mund të çënojë aftësinë mësimdhënëse të tyre. Gjithsesi gjatë takimit me personelin akademik, pedagogët treguan një shkallë të lartë angazhimi për përmbushjen e objektivave të ciklit të parë.</p> <p><i>[Referenca: 2.22.1 CV e stafit akademik te prog & ndihmes.pdf; Informacion shtesë: Lista e pedagogeve FB.pdf; 2.21.1 Te dhena tabelore per personelin akademik.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Që nga viti 2021, KUW ushtron veprimtarinë në një godinë gjashtë katëshe të marrë me qira në Autostradën Durrës-Tiranë me një sipërfaqe totale 4249,8m² nga të cilat 3151,8m² sipërfaqe ndërtimi. Kontrata e qirasë mundëson përdorimin e godinës nga KUW deri në vitin 2026. Godina ndodhet larg qendrës së Tiranës dhe nuk është lehtësisht e aksesueshme nga transporti publik. Megjithatë institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve dhe personelit një mjet transporti, i cili bën transportimin e tyre për në dhe nga KUW.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike</p>	

dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Të dhënat në vijim i referohen përmbledhtas mjediseve kryesore në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik pranë KUW:

MJEDISI	NR. SALLAVE
Salla leksioni	10
Salla seminari	10
Laborator informatike/lëndësh	2
Zyra për personelin akademik	5
Bibliotekë / Internet	2
Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	7

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme, me ndriçim optimal, të pajisura me sistem ngohje-ftohjeje dhe me pajisjet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjedise të tjera dhe vuri re që mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe sistem fonie si dhe kanë ndriçim optimal për kryerjen e veprimtarisë mësimore. [Referenca: 2.28 Planimetria & infrastruktura; 2.29 Kontrate qeraje; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Sallat ku zhvillohet mësimi i programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe pajisje fonie. KUW vë në dispozicion të studentëve një laborator për lëndët dhe një laborator informatike të pajisur me aparaturat dhe mjetet e nevojshme. Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se vetëm lëndët “Informatikë” dhe “Paraja dhe Banka” ka parashikuar secila 15 orë laboratorike, ndërkohë që laboratorët mund të përdoren nga studentët për kryerjen e analizave apo detyrave/projekteve të kursit.

Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së

Institucioni ka një laborator informatike dhe një laborator lënde, të pajisur PC dhe programe që u mundësojnë studentëve të kryejnë orët laboratorike. Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se laboratorët përdoren për realizimin e dy lëndëve: “Informatikë” dhe “Paraja dhe

programit/ eve të studimit që ofron.	Banka". [Referenca: 2.28 Planimetria & infrastruktura;; 3.04 Planet mësimore; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Për realizimin e praktikës profesionale KUW ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, të cilët u garantojnë dhe u ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij programi studimi. Praktika profesionale zgjat pesë javë dhe zhvillohet me shkëputje nga procesi mësimor. Gjatë takimit me studentë të programit, një prej tyre e kishte kryer praktikën në një institucion financiar, një student pranë një biznesi ndërsa tre të tjerët në studio kontabiliteti. Studentët konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës. [Referenca: 4.04.1 MB ne rang IAL.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	KUW vë në dispozicion të studentëve një bibliotekë me sipërfaqe 72,4m ² dhe një sallë interneti 53,2m ² . Salla e bibliotekës është e pajisuar me sistem ngrohje-ftohjeje dhe ndriçim optimal, ka 45 vënde pune dhe 12 laptop-ë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve. Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit. Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pasur me literaturë fizike – rreth 1.456 tituj librash në një total prej 3.589 kopje dhe 64.862 revista dhe buletine shkencore në shqip dhe gjuhë të huaj (sipas RVB) në fusha të disiplinave të ndryshme të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të KUW. Fondi i librave në bibliotekë përbëhet nga tekste mësimore, periodikë, revista e buletine shkencore, fjalorë, teza diplomash etj. Për programet e
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas	


natyrës e specifikës së programit të studimit.	Departamentit të Ekonomisë, biblioteka disponon rreth 270 tituj libra fizikë. GVJ konstatoi se Biblioteka dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit. [Referenca: 2.20 Relacion biblioteka; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët e këtij programi na u konfirmua se ata kanë mundësi të përdorin pa pagesë si literaturën fizike të disponueshme në bibliotekë edhe bibliotekën elektronike. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën elektronike Proquest. Sipas dokumentacionit shoqërues të RVB rreth 136.537 tituj në fushëm e ekonomisë janë të aksesueshëm on-line pa pagesë nga studentët dhe pedagogët.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ka internet dhe është e pajisur me kompjutera (12 laptopë) që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike. [Referenca: 2.20 Relacion biblioteka; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni nxiti njësinë bazë dhe kryesore të përditësojë fondin ekzistues të literaturës së programit të studimit. Gjatë takimit me personelin akademik të programit të studimit, pedagogët u shprehën se institucioni i plotëson kërkesat e tyre për literaturën që ata e vënë në shërbim të programit të studimit.*Kjo literaturë mund të jetë fizike në bibliotekë, ose në formatin elektronik. Institucioni vazhdimisht bën pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj në bazë të nevojave të departamenteve. [Referenca: 2.20.1 Propozim për blerje librash; 2.20.2 Dekani për blerje librash; vizita në institucion]			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, GVJ iu konfirmua se biblioteka është e hapur në orare duke iu përshtatur edhe orareve të zhvillimit të procesit mësimor. Mësimi për këtë program studimi zhvillohet paradite, por meqënëse programet e nivelit të dytë të studimit zhvillohen mbasdite, biblioteka është e hapur nga ora 8.30-19.30. [Referenca: 1.08 Rregullore e Bibliotekës; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Ne bazë të rregulloreve të institucionit, informacioni që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre administrohet nga sekretaria mësimore dhe dokumentacioni ruhet në formatin fizik dhe elektronik në sekretari. Gjatë vizitës në sekretari GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. [Referenca: 1.02 Rregullore e KUW; 1.07 Rreg. sekretarisë mësimore; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni dhe dokumentacioni i veprimtarisë së personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ të institucionit dhe në veçanti të personelit akademik të programit të studimit ruhet dhe administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. [Referenca: 1.09 Rreg. Burimeve Njerëzore Kesh. Karrierës Jetës Studentore KUW; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik dhe ndihmës akademik, mund të aksesojnë dhe sigurojnë informacionin përkatës nëpërmjet portalit të studentit, në përputhje me ligjin e ruajtjes së privatësisë së informacionit personal. Portali i studentit që përdoret aktualisht për programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë” siguron akses të dedikuar për studentët, personelin akademik dhe personelin administrativ. [Referenca: 1.18 Politikat institucionale të publikimit të informacionit; http://portal.hstalb.xyz/]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik, komunikojnë dhe shkëmbejnë informacion përmes portalit të studentit, në të cilin jo vetëm mund të ngarkohen materialet e pedagogëve, por mund të zhvillojnë diskutime në grup. Gjatë vitit akademik 2019-2020, mësimi është zhvilluar on-line dhe institucioni ka përdorur platforma të ndryshme si Teams për zhvillimin e procesit mësimor dhe vënien në dispozicion të studentëve të materialeve mësimore. Gjatë vitit 2021-2022 është vënë pjesërisht në funksion platforma „WeSchool“, e cila mendohet që vitin e ardhshëm të vihet në funksion të të</p>

	gjithë programeve të studimit që ofron institucioni, përfshirë edhe programin e studimit “Bachelor në Financë-Bankë”.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua edhe nga takimet me personelin akademik dhe ndihmës akademik, se sistemi i menaxhimit të informacionit në KUW u mundësonte drejtuesve dhe titullarëve të institucionit të dhëna dhe raportime në kohë reale dhe në distancë.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacioni që lidhet me programet e studimit, personeli akademik dhe aktivitetet e tjera që lidhen me procesin mësimor dhe aktiviteti kërkimor-shkencor publikohen në faqen e internetit kryesisht në gjuhën shqipe. Në gjuhën angleze publikohet vetëm një pjesë e informacionit. Në takimet gjatë vizitës në KUW, GVJ u informua se faqja zyrtare në internet dhe informacionet në të ishin në proces përditësimi për shkak të riorganizimit, të kushtëzuar nga ndryshimet në strukturën e pronësisë. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; https://wisdom.edu.al/programet-mesimore ; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUW harton çdo vit projekt buxhetin në nivel institucioni dhe jo për programe studimi, si dhe harton pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi. [Referenca: 2.31 Projekt buxheti; 2.33 Të ardhurat dhe financimet; 2.33.2 Pasqyrat financiare; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në	Sipas statutit KUW projekt buxheti vjetor hartohet në nivel institucioni nga Administratori mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë, mbështetur në planin

<p>shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në atë të veprimtarisë vjetore të KUW dhe ia paraqet Bordit të Administrimit për miratim. Në takimin me personelin akademik të programit, GVJ u informua se njësisia bazë si pjesë të analizës vjetore bën propozimin e saj lidhur me investimet në pajisje, infrastrukturë, pasurim biblioteke, aktivitete shkencore etj. Plani financiar i institucionit përmban të detajuara të ardhurat që vijnë nga studentët dhe nga projektet si dhe shpenzimet administrative, për paga dhe për kërkim shkencor, si dhe shpenzime për investime dhe teknologji. [Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 2.31 Projekt buxheti; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni harton pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas dokumentacionit shoqërues të RVB, për vitin 2022, institucioni parashikon të realizojë një total të ardhurash prej 83'687'587 lekë, të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e vitit përkatës. 91, 93% e të ardhurave të institucionit vijnë nga tarifat e studentëve; 0,51% nga dhënia e ambienteve me qira, 5,76% nga projektet dhe pjesa tjetër nga shërbime të tjera. Lidhur me shpenzimet, ato janë kategorizuar sipas dy njësive kryesore të institucionit dhe janë detajuar në shpenzime për paga, shpenzime administrative dhe shpenzime operative ku përfshihen shpenzimet për teknologji dhe kërkim zhvillim, shpenzime për bibliotekë, për konferenca, konsulencë etj. Dokumentacioni financiar që shoqëron RVB përbëhet nga një përmbledhëse të ardhurash dhe shpenzimesh që i përkasin viteve 2017, 2018 dhe 2019 dhe pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020. Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve, GVJ konstaton se për vitin financiar 2020 të ardhurat e siguruara nga institucioni nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve (ka rezultuar me humbje) ndërsa për vitin 2019 të ardhurat kanë mbuluar shpenzimet duke i sjellë institucionit një rezultat minimal pozitiv (fitim). Institucioni ka detyrim ligjor të kryejë auditimin vjetor të pasqyrave financiare nga një auditues ligjor i pavaruar, por GVJ nuk ju vu në dispozicion ky raport. [Referenca: 2.31 Projekt buxheti; 2.33.2 Pasqyrat financiare; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në KUW, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të dedikuara në</p>

raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	mbyllje të një cikli të plotë studimi dhe sipas programeve të studimit, por harton një raport vjetor të analizës së veprimtarisë në nivel institucioni. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, ku për dy vitet e fundit të raportuar institucioni rezulton përkatësisht me humbje dhe një rezultat pozitiv minimal, si dhe në mungesë të raportit nga audituesi ligjor për të paktën një nga tre vitet e fundit të aktivitetit ekonomiko-financiar të institucionit, GVJ nuk mund të shprehet mbi qëndrueshmërinë financiare të KUW. [Referenca: 2.33.1 Pasqyrat financiare.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit janë të përcaktuara plotësisht në Statutin e KUW (Kreu V) dhe Rregulloren e KUW (Kreu VI), Rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. [Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.02

	<i>Rregullore e K UW; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Rregulloret e njësisve kryesore dhe bazë dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera. Sipas rregullores së programit të studimit përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të paanësisë dhe meritës.</p> <p>Siç u përmend edhe në pjesën e parë të këtij raporti, nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se studentët mund të transferoheshin nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në vitin e dytë në K UW duke patur të paktën 20 kredite (<i>neni 57 i Rregullores së K UW dhe neni 21 i rregullores së DE</i>), ndërkohë që studentët ekzistues në K UW mund të kalonin në vitin e dytë nëse grumbullonin të paktën 30 kredite. Ky rregull vendos në pozita të disfavorshme studentët ekzistues në krahasim me studentët që transferohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p><i>GVJ sugjeron rishikimin e e kuadrit rregullator të K UW për të harmonizuar kërkesat lidhur me transferimin dhe përparimin e studentëve nga një vit akademik në tjetrin për të mos lënë hapësirë për interpretime të dyfishta. [Referenca: 1.02 Rregullore e K UW; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB; 2.37 Rregullore transferimeve.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera janë përcaktuar në statutin dhe Rregulloren e K UW të cilat janë të publikuara on-line në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. [Referenca: 1.01 Statuti i K UW; 1.02 Rregullore e K UW; https://wisdom.edu.al/rregullorja-dhe-statuti; vizita në institucion]</p>
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e	Institucioni përcakton çdo vit akademik kuotat dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të

kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	studimeve dhe informon kandidatët mbi përmbajtjen e programeve të studimit që ofrohen nga KUW.			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në KUW përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e KUW, ndërsa kriteret e veçanta përcaktohen çdo vit nga Departamenti i Ekonomisë. Pranimi në programin e studimit "Bachelor në Financë-Bankë" është i mundur për studentët që zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme brenda ose jashtë vendit dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të KM. [Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.02 Rregullore e KUW; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB; RVB.Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Nga vizita në institucion GVJ iu konfirmua se kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen nëpërmjet fletëpalosjeve dhe guidave, njoftimeve në faqen zyrtare të internetit të universitetit, javëve të informimit, si dhe takimeve të drejtpërdrejta me të interesuarit. Guida e cila është e aksesueshme on-line në faqen e institucionit, përmban informacion mbi planin mësimor të këtij program studimi. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit ; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik është i aksesueshëm on-line në faqen zyrtare të internetit të institucionit, në të cilën janë publikuar Statuti dhe Rregullorja e KUW. [Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.02 Rregullore e KUW; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Rregullorja e transferimeve që është ndërtuar në bazë të Satutit dhe Rregullores së njësisë kryesore, përcakton kriteret dhe procedurat që ndiqen për njohjen e kualifikimeve të

<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme gjatë transferimit të studimeve. Statuti dhe Rregullorja e KUW publikohen online dhe studentët dhe palët e interesuara kanë mundësi të informohen në çdo kohë mbi këtë çështje. [Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.02 Rregullore e KUW; 2.37 Rregullore e transferimeve]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Programet e lëndëve të hartuara në bazë të rregulloreve të njësisë kryesore dhe bazë dhe rregullores së programit të studimit përmbajnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, këto kriteret dhe procedura u komunikohen studentëve nga pedagogët gjatë orës së parë të mësimin, ku u prezantohet programi i lëndës. Pothuajse çdo program mësimor (syllabus) përmban kriteret e vlerësimit të studentëve bazuar në rregulloren e programit të studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi final rezulton përgjithësisht i harmonizuar mes lëndëve (me përjashtim të dy lëndëve) dhe përcaktohet në masën:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 30% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera të vijueshme si teste, raste studimore, detyra dhe projekte kursi; ▪ 70% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit; <p>[Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.02 Rregullore e KUW; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; 3.10 Programe mesimore.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se kuadri rregullator i KUW ka parashikuar një procedurë të plotë për mënyrën e diplomimit të studentëve. Konkretisht diploma e ciklit të studimeve “Bachelor” mbrohet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me temë diplome nëse mesatarja e notave të fituara nga studenti deri në semestrin e pestë përpara diplomimit është mbi nivelin e notës mesatare të përcaktuar në rregulloret e Fakultetit apo Departamentit. Sipas RVB ky kriter aktualisht është 8.5.</p> <p>Por GVJ konstaton një mospërputhje me kërkesat e rregullores së programit të studimit e cila parashikon vetëm mbrojtjen e diplomës me temë. Gjithashtu në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se të gjithë studentët do e mbronin diplomën me provim formimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon që edhe për këtë aspekt Rregullorja e Programit të Studimit “Bachelor në Financë-Bankë” duhet të</i></p>

	<p><i>rishikohet dhe përditësohet me kërkesat e kuadrit kryesor rregullator të KUW.</i></p> <p><i>[Referenca: 1.02 Rregullore KUW.pdf; 2.06 Rregullore e FSHESH.pdf; 2.08 Rregullore e DE.pdf; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; RVB bachelor finance-banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u informua se çdo vit akademik, KUW merr pjesë në panaire dhe organizon ditët e orientimit nëpërmjet të cilës maturantët dhe studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Guida e publikuar on-line në faqen zyrtare të internetit përmban informacion mbi planin mësimor të programit të studimit dhe të interesuarit mund ta aksesojnë në çdo kohë.</p> <p><i>GVJ rekomandon se në këtë drejtim duhet të bëhet më shumë sepse vitin e fundit akademik në programin e studimit nuk është regjistruar për herë të parë asnjë student, por janë transferuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</i></p> <p><i>[Referenca: 3.15 Guida e studentit; 3.17 Ditët e informit të maturanteve.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet përmes publikimit të informacionit në faqen zyrtare të internetit të KUW, në stenda në ambientet e institucionit dhe në rrjete sociale. Gjithashtu këtë informacion studentët e marrin edhe nga sekretaria mësimore dhe nga takimi me personelin akademik. Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve dokumentacionin dhe udhëzuesit për lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, duke përfshirë planin mësimor dhe syllabuset. Orën e parë të çdo lënde, pedagogu prezanton studentët me objektivat e lëndës, njohuritë që do të marrin në lëndën</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët,</p>	

përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	përkatëse, literaturën ku do të mbështeten dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive. [Referenca: 3.10 Programe mësimore; 3.16 Udhëzues didaktik]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	KUW informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet specialistes së Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, departamentit përgjegjës të Ekonomisë dhe Koordinatorit të programit të studimit. Për këtë qëllim, si procedure, organizohen takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme si edhe trainime me studentët për mënyrën se si duhet të aksesojnë në tregun e punës, si të shkruajnë një CV, një letër motivimi apo si duhet të përgatiten për një intervistë. Në lidhje me këto çështje studentët kanë mundësi të aksesojnë online udhëzuesin e karrierës të përgatitur nga kjo zyrë. [Referenca: 3.18 Nga zbnjkk si te bejme aplikim pune.pdf; 3.19 Udhëzuesi i karrieres.pdf; https://wisdom.edu.al/udhezuesi-i-karrieres]
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor (sallat e zhvillimit të leksioneve, seminareve, laboratorët, biblioteka, zyrat dhe ambientet ndihmëse, orari mësimor, plani mësimor, ndryshimet e orarit) u komunikohen studentëve nga sekretaria mësimore dhe specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Gjithashtu, ky informacion ofrohet në stendat e ambienteve të KUW, si edhe në faqen zyrtare në internet dhe rrjetet sociale të institucionit. Në takimet gjatë vizitë në KUW, GVJ u informua se faja zyrtare në internet dhe informacionet në të ishin në proces përditësimi për shkak të riorganizimit, të kushtëzuar nga ndryshimet në strukturën e pronësisë. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; https://wisdom.edu.al/programet-mesimore; vizita në institucion/]
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	KUW u ka mundësuar studentëve që të informohen lidhur me programin e studimit në çdo kohë dhe në distancë nëpërmjet logimit në Portalin e studentit, i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët në çdo kohë dhe distancë. Në takimet gjatë vizitë në institucion, GVJ mori konfirmimin se vitin e ardhshëm akademik do të vihej në funksion edhe të studentëve të këtij program studimi platforma WeSchool, në të cilën do të kenë akses të dedikuar studentët, personeli akademik dhe sekretaria mësimore. [Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; http://portal.hstalb.xyz/ ; vizita në institucion]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																									
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Rregullorja e K UW (neni 114) ngarkon sekretarinë mësimore si njësinë përgjegjëse për rregullimin, ndjekjen dhe arkivimin e çdo regjistrimi, të dhëne, dokumente apo listë notash që lidhet me studentin për programet e studimit, përfshirë këtu edhe statistikat vjetore të të diplomuarve. Sekretaria Mësimore e K UW ruan në format elektronik dhe në formatin letër të gjitha të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” dhe konstatoi plotësinë e tyre. [Referenca: 1.02 Rregullore e K UW; vizita në institucion]</p>																									
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>K UW disponon statistika vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar, të diplomuar dhe të larguar (çregjistruar) nga programi i studimit. Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi të siguruara gjatë verifikimit të regjistrave që disponon sekretaria mësimore:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Të çregjistruar</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>0 studentë</td> <td>8 studentë</td> <td>-</td> <td>Në proces</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>3 studentë</td> <td>9 studentë</td> <td>-</td> <td>14 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>2 studentë</td> <td>21 studentë</td> <td>3 studentë</td> <td>16 studentë</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>7 studentë</td> <td>22 studentë</td> <td>5 studentë</td> <td>10 studentë</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të çregjistruar	Të diplomuar	2021-2022	0 studentë	8 studentë	-	Në proces	2020-2021	3 studentë	9 studentë	-	14 studentë	2019-2020	2 studentë	21 studentë	3 studentë	16 studentë	2018-2019	7 studentë	22 studentë	5 studentë	10 studentë
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të çregjistruar	Të diplomuar																						
2021-2022	0 studentë	8 studentë	-	Në proces																						
2020-2021	3 studentë	9 studentë	-	14 studentë																						
2019-2020	2 studentë	21 studentë	3 studentë	16 studentë																						
2018-2019	7 studentë	22 studentë	5 studentë	10 studentë																						

	Siç u përmend edhe më parë, transferimet zënë një peshë të rëndësishme në numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. <i>[Referenca: 2.14 Të dhëna tabelore studentët; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Veprimtaria e sekretarisë mësimore rregullohet nga (neni 114) i Rregullores së KUW dhe nga Rregullorja e Sekretarisë Mësimore. Sekretaria mësimore ruan dokumentacionin lidhur me të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në momentin e largimit/diplomimit të tyre: regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave me shkrim dhe elektronik. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u konsultua me regjistrin themeltar, me regjistrin e arritjeve akademike dhe me regjistrin e diplomave. GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” dhe konstatoi plotësinë e tyre. Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve (numri i matrikullimit, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, vlerësimi i arritjeve të studentëve dhe të dhëna të tjera personale) ruhen në sistemin e brendshëm të informacionit dhe aksesohen lehtësisht nga personat e autorizuar. Manaxhimi elektronik i të dhënave bëhet nëpërmjet portalit të studentit, ku çdo person i autorizuar mund të aksesojë dhe verifikojë lehtësisht informacionin. Të dhënat ruhen edhe në formatin letër në dosjet personale të studentëve dhe në regjistrat përkatës që plotëson sekretaria mësimore. <i>[Referenca: 1.02 “Rregullore e KUW; 1.07 Rreg.sekretarisë mësimore; vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë në fund të vitit kryen një analizë vjetore, ku midis të tjerave raporton mbi ecurinë e performancës së studentëve gjatë vitit akademik. Rezultatet e kësaj analize përfshihen në raportin vjetor të FSHESH dhe së bashku me raportin e përgatitur nga NJBSC i dërgohet për shqyrtim Rektorit, i cili në bashkëpunim me Dekanët merr masat e duhura për përmirësimin e treguesve. <i>[Referenca: 2.05 Raporti vjetor; 2.07 Analiza vjetore e FSHESH; 2.12 Analizë vjetore e DE; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Statuti i KUW parashikon përfshirjen e studentëve në disa organe vendimmarrëse dhe këshilluese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Këshilli i studentëve, nëpërmjet të cilit realizohet pjesëmarrja e studentëve dhe koordinohet përfaqësimi i tyre në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve; ▪ Senati akademik, ku dy anëtarë zgjidhen nga studentët; ▪ NJSBC, ku një nga pesë anëtarët është student; ▪ GVB, ku një student është përfshirë në hartimin e RVB.
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, studentët konfirmuan angazhimin e tyre aktiv të drejtëpërdrejtë me anën e plotësimin të pyetësorëve apo takimet me anëtarë të NJSBC ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të tyre për dhënien e mendimeve të tyre lidhur me procesin akademik.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti i KUW; 1.13 Rreg. e keshillit studentor.pdf; 2.03 Vendim i rektorit.pdf; 2.04 Vendimi dekanit plani i punes dhe vendimi i GVB.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit “Bachelor në Financë-Bankë” është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë tre viteve të zhvillimit të procesit mësimor. Sipas planit mësimor, dy vitet e para dhe semestrin e parë të vitit të tretë kanë mesatarisht nga 20-23 orë mësimi në javë, ndërsa semestrin e fundit gjatë të cilit kryejnë edhe praktikën mësimore, zhvillojnë 14 orë në javë. Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rregullohet me Rregulloren KUW (nenet 56 dhe 57). Sikurse është shprehur edhe më sipër, GVJ konstaton se numri i krediteve që kërkohet për transferimin në vitin e dytë apo të tretë është më</p>

	i vogël se numri i krediteve që kërkohet për përparimin nga një vit në vitin pasardhës të studimeve. [Referenca: 1.02 Rregullore e KUW; 3.04 Plani mësimor]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në tō.	Përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve mësimore bëhet së pari nëpërmjet pyetësorëve çdo semester, nëpërmjet të cilëve studentët japin mendimet e tyre lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, por edhe nëpërmjet intervistave informale që zhvillohen periodikisht nga anëtarë të personelit akademik dhe përfaqësues të NJSBC. Rezultatet e tyre përpunohen dhe përfshihen në analizën dhe raportin vjetor që përgatit institucioni.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Kuadri rregullator i KUW, në nenet përkatëse, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe/ ose vlerësimin në provim kundrejt një kërkese me shkrim që i drejtohet Përgjegjësës së Departamentit. Ankesa për procesin duhet të paraqitet 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 48 orëve nga komunikimi i rezultateve të provimit. Përgjegjësja e Departamentit në bashkëpunim me komisionin e provimeve bëjnë verifikimet dhe rishikimin sipas situatës.</p> <p>Në raste të problematikave të veçanta Përgjegjësja e Departamentit vë në dijeni Dekanin e FSHESH i çili brenda 48 orëve nga njoftimi vijon me ngritjen e një komisioni të posaçëm për të bërë verifikimet e nevojshme lidhur me ankesën e studentit. GVJ konstaton se kuadri rregullator i KUW u jep siguri studentëve për barazi dhe paanshmëri në vlerësimin e njohurive.</p> <p>[Referenca: 1.5 Raporti Vjetor i Monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë; 2.19.5 Relacion semestral (model template).pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit; 2.43 Relacione takime studentësh me NJSBC; 3.01 Rregullore e prog.studimit FB.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Plotësisht përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>KUW ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillit të Karrierës dhe Jetës Studentore, ku një nga specialistët ofron shërbimin e këshillimit dhe informimit të studentëve. Informimi i studentëve bëhet nga sekretaria mësimore, personeli akademik nëpërmjet adresave të tyre zyrtare të e-mailit. Gjithashtu informacionet mbi aktivitetet që lidhen me procesin mësimor publikohen në faqen zyrtare të institucionit, ku studentët mund të marrin informacion në kohë reale dhe në distancë.</p> <p><i>[Referenca: 1.02 Rregullore K UW.pdf; Dokumenti "Rregullore e ZBNJKK&JS"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në <i>nenin 115</i> të rregullores së KUW, intitucioni ka ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore (ZBNKK&JS), e cila funksionon në bazë të përcaktimeve në aktet rregullatore të institucionit dhe të rregullores së saj. Specialisti i ZBNJKK&JS ka për detyrë mbështetjen dhe informimin e studentëve gjatë studimeve të tyre akademike nëpërmjet trainimeve, seminareve informuese, forumeve, panairëve të punës, takime dhe vizita në institucione të ndryshme publike dhe private në mënyrë që studentët të vendosin kontakte me punëdhënësit potencialë etj. Një vlerë e shtuar në këtë drejtim është edhe ngritja e Bordit Këshillimor të Biznesit, krijimi i të cilit ka për qëllim të orientojë studentët drejt tregut të punës.</p> <p><i>[Referenca: 1.02 Rregullore e KUW.pdf; Dokumenti "Rregullore e ZBNJKK&JS"; 2.25 Vendim Bordi i Biznesit; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të</p>	<p>Specialisti përgjegjës i Zyrës për këshillimin e karrierës dhe jetës studentore përgatit informacione orientuese për studentët, jep informacion mbi planet mësimore, kurrikulat dhe diplomat që ofron KUW, orienton studentët për të hyrë në tregun e punës, ndjek praktikat e studentëve, mban të dhëna për punësimin e të diplomuarve, organizon aktivitete ekstrakurrikulare në bashkëpunim me këshillin studentor, informon maturanet aplikante mbi programet e studimit që ofron KUW etj. Gjithashtu kjo strukturë me specialisten përgjegjëse ka për detyrë të mbështesë studentët e diplomuar në mënyrë që ata të orientohen dhe të përshaten më mire në</p>

tjera dhe orientimin në tregun e punës.	tregun e punës. Ajo mbledh të dhënat për të diplomuarit, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p><i>GVJ gjykon se struktura e specialistes së Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore duhet të ndahet nga zyra e Burimeve Njerëzore sepse pavarësisht madhësisë së kufizuar të programeve të KUW (në numër studentësh), organizimi aktual në një strukturë/zyrë të vetme mund të sjellë problematika në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, prandaj rekomandojmë ndarjen dhe plotësimin e këtyre strukturave me burime njerëzore të dedikuara për të rritur eficientë dhe efikasitetin e punës së tyre.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.39 Të dhëna punësimi i studentëve.pdf; 3.18 Nga ZBNJKK si te bejme aplikim pune.pdf; Dokumenti "Rrregullore e ZBNJKK&JS"; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, neni 11 i Statutit të KUW parashikon ngritjen e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe hartimin, nga institucioni, të politikave dhe procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NJSBC vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të KUW dhe harton raportin përkatës të vlerësimit të brendshëm. Detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBC përcaktohen në rregulloren e saj. Institucioni ka ngritur dhe ka vënë në
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional	

<p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>zbatim Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Rregullorja e sigurimit të cilësisë përcakton organet drejtuese dhe autoritetet e KUW përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe garantimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të KUW si: Bordi i Universitetit, Rektori, Senati, Komisioni për Garantimin dhe Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Këshilli Studentor, si dhe NJSBC e cila është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe instrumentave të vlerësimit të brendshëm të KUW. NJSBC përbëhet nga pesë anëtarë, një prej të cilëve është student.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.06 Rregullore NJSBC KUW; 2.19 Emërimi i anëtarëve të NJSBC; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilësisë]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni dhe programi i studimit “Bachelor në Financë-Bankë” i është nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.</p> <p>Ky program studimi është akredituar më 17.10.218 me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.72 me rekomandime, për realizimin e të cilave GVJ ka dhënë opinionin në hyrje të këtij raporti. <i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 2.02.1 Vendim nr. 72 I KA TE ASCAL.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë, Kodin e Cilësisë dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, KUW ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, që synojnë krijimin dhe promovimin e kulturës së përmirësimit të cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit si një përgjegjësi personale dhe kolektive njëkohësisht.</p> <p><i>[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.06 Rregullore NJSBC KUW; 2.19 Emërimi i anëtarëve të NJSBC; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilësisë]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e NJSBC ndër funksionet kryesore të saj është vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit dhe i procesit mësimdhënës, si vlerësimi i aktivitetit kërkimor-shkencor (neni 13 dhe 14) me qëllim përmirësimin e cikleve dhe programeve të studimit të ofruar nga KUW. [Referenca: 1.06 Rregullore NJSBC KUW; 2.19.7 Politikat e garantimit të standarteve e cilësisë]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua përdorimi i pyetësorit të studentëve dhe pedagogëve si një mekanizëm për të siguruar informacion mbi përmbajtjen e programit të studimit, lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimit të personelit akademik dhe infrastrukturën në dispozicion të studentëve. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si rregullorja e NJSBC dhe politikat për garantimin e cilësisë në KUW, GVJ konstaton se përcaktohen prioritetet dhe fushat e veprimtarisë së NJSBC, por nuk dokumentohen qartë formalisht mekanizmat dhe instrumentat që përdor institucioni për arritjen e objektivave të procesit të sigurimit të cilësisë. <i>GVJ gjykon që aktet rregullatore të institucionit duhet të shprehin qartë dhe konkretisht instrumentet që përdoren për vlerësimin e cilësisë.</i> [Referenca: 1.06 Rregullore NJSBC KUW; 2.19.7 Politikat e garantimit të standarteve e cilësisë; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Pavarësisht se aktet rregullatore nuk përcaktojnë mekanizmat formalë të vlerësimit të ecurisë së programeve të studimit, gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUW përdor si instrument për matjen dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pyetësorët e studentëve nëpërmjet të cilëve përfitohet informacion mbi cilësinë e programit të lëndëve, zhvillimit të procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies nga pedagogu dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të studentit; ▪ Pyetësorët që plotësohen nga pedagogët, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi metodologjinë didaktike, marrëdhëniet me institucionin dhe



	<p>kolegët, aksesin në trajnime dhe konferenca për monitorimin e kërkimit të tyre shkencor;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kontrolle të procesit mësimor sipas kalendarit semestral dhe sipas cikleve të studimit; ▪ Intervistat informale me studentët dhe takime të përbashkëta me studentë dhe pedagogë të KUW, në fund të çdo semestri, me objekt ecurinë dhe problematikat e ndeshura gjatë mësimdhënies; <p>GVJ konstaton se NJBSC ushtron veprimtarinë e saj në bazë të një plani kalendarik i cili mbulon gjithë procesin e vlerësimit nga hartimi dhe zbatimi i instrumentave deri tek përpunimi i rezultateve, raportimi dhe analizimi i raporteve nga organet drejtuese. [Referenca: 1.06 rregullore NJSBC.pdf; 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilësisë.pdf; 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.19.6 Relacion kalendarit e kontrollit.pdf; 2.36 Model vlerësimi i performances stafit akademik.pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit.pdf; 2.43 Relacione takime studentësh me NJBSC.pdf; vizita në institucion]</p>								
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të rezultateve të përfituara nga pyetësorët dhe intervistat, NJBSC harton “Raportin e Vetëvlerësimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” Raporti i prezantohet Senatit i cili analizon diskuton dhe merr vendim mbi zgjidhjen e problemeve dhe sugjerimet e paraqitura në raport. Rezultatet e pyetësorëve pasi përpunohen i paraqiten me shkrim Rektorit dhe për dijeni Dekanit të FSHESH. Vendimi i Senatit reflektohet në Planin Strategjik të institucionit por edhe në planet afatmesme dhe afatshkurtra në nivel institucioni dhe njësisë. Raporti i miratuar nga Senati sipas nenit 26 të Rregullores së NJBSC, përmban pikat e dobëta dhe të forta të evidentuara gjatë procesit të vetëvlerësimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të aktivitetit kërkimor-shkencor të institucionit.</p> <p>[Referenca: 1.06 rregullore NJSBC.pdf; 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilësisë.pdf; vizita në institucion]</p>								
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në bazë të rezultateve të përfituara nga pyetësorët dhe intervistat, NJBSC harton “Raportin e Vetëvlerësimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” Raporti i prezantohet Senatit i cili analizon diskuton dhe merr vendim mbi zgjidhjen e problemeve dhe sugjerimet e paraqitura në raport. Rezultatet e pyetësorëve pasi përpunohen i paraqiten me shkrim Rektorit dhe për dijeni Dekanit të FSHESH. Vendimi i Senatit reflektohet në Planin Strategjik të institucionit por edhe në planet afatmesme dhe afatshkurtra në nivel institucioni dhe njësisë. Raporti i miratuar nga Senati sipas nenit 26 të Rregullores së NJBSC, përmban pikat e dobëta dhe të forta të evidentuara gjatë procesit të vetëvlerësimit si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të aktivitetit kërkimor-shkencor të institucionit.</p> <p>[Referenca: 1.06 rregullore NJSBC.pdf; 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilësisë.pdf; vizita në institucion]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="580 1541 767 1637">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="767 1541 959 1637">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="959 1541 1145 1637">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1145 1541 1327 1637">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="580 1637 767 1693"></td> <td data-bbox="767 1637 959 1693"></td> <td data-bbox="959 1637 1145 1693"></td> <td data-bbox="1145 1637 1327 1693" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se KUW kryen monitorime dhe vlerësime periodike për cilësinë e programit të studimit. Pyetësorët plotësohen nga studentët dhe personeli akademik çdo semestër dhe intervistat dhe takimet me studentët kryhen vazhdimisht.</p> <p><i>GVJ rekomandon që rregullorja e NJBSC duhet të specifikojë qartë jo vetëm instrumentat por edhe shpeshhtësinë e përdorimit të tyre nga institucioni.</i></p> <p><i>[Referenca: 1.06 rregullore NJSBC.pdf; 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit të cilësisë.pdf; 2.19.2 Plani veprimtarive të NJBSC.pdf; 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit.pdf; 2.43 Relacione takime studentësh me NJBSC.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUW ka përdorur instrumente të ndryshme në përshtatje me programin e studimit për vlerësimin e tij, si: pyetësorët për studentët, pyetësorët për pedagogët, intervistat informale me studentët, vlerësimin e veprimtarisë kërkimore të personelit si dhe relacione dhe analiza të kryera nga NJSBC. <i>[Referenca: 2.19.2 Plani veprimtarive të NJBSC.pdf; 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit.pdf; 2.43 Relacione takime studentësh me NJBSC.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, KUW nëpërmjet metodave të drejtëpërdrejta që përdor në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, merr informacion mbi vlerësimin e kurrikulave, planit mësimor, metodave didaktike të mësimdhënies, vlerësimin e ecurisë dhe angazhimit të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që këto metoda të pasurohen edhe me dëgjimet dhe vëzhgimet në auditor nga Profesorati, veçanërisht për pedagogët dhe kërkuesit e rinj shkencorë, si një metodë e drejtëpërdrejtë e vlerësimit dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies nga pedagogët e rinj.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit.pdf; 2.43 Relacione takime studentësh me NJBSC.pdf]</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW përdor intervistat informale me studentët dhe takimet me studentë dhe pedagogë si një instrument për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të zgjerohet komuniteti i kryerjes së sondazheve dhe intervistave, jo vetëm tek personeli akademik dhe ndihmës akademik por edhe tek studentët e diplomuar alumni, opinioni i të cilëve ka një vlerë të veçantë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit veçanërisht në lidhje me përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>[Referenca: 2.19.2 Plani veprimtarive të NJBSC.pdf; 2.19.5 Relacion semestral.pdf; 2.41 Relacione pyetësori studentit.pdf; 2.43 Relacione takime studentësh me NJBSC.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kuadri rregullator kryesor i KUW, Statuti dhe Rregullorja e tij, si dhe Rregullorja e vlerësimit të brendshëm të cilësisë përcaktojnë qartë organet që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit si: Bordi i Universitetit, Rektori, Senati, Komisioni për garantimin dhe sigurimin e standardeve të cilësisë, Këshilli Studentor, si dhe NJSBC.</p> <p>Komisioni për garantimin dhe sigurimin e standardeve të cilësisë, bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë, ka hartuar një dokument “Politikat për garantimin e standardeve të cilësisë”, në të cilin ka evidentuar qartë njësitë apo strukturat që përfshihen në sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe rolet që ka secila prej tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	[Referenca: 1.01 Statuti KUW.pdf; 1.02 Rregullore KUW.pdf; 1.06 Rregullore NJSBC KUW.pdf; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilesise.pdf]			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Procesi i vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit është gjithëpërfshirës, duke përfshirë jo vetëm studentët dhe personelin akademik në dhënien e opinioneve të tyre për programin e studimit, por duke i përfshirë edhe në përbërjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Një anëtar i NJSBC është personel akademik i Departamentit të Ekonomisë, i angazhuar në programin e studimit dhe gjithashtu edhe një student është anëtar i NJSBC. [Referenca: 2.19 Emerimi i anetareve te NJSBC.pdf; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilesise.pdf]			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Procesi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është gjithëpërfshirës dhe GVJ konstaton se pyetësorët dhe instrumentet e tjerë të përdorur në këtë proces nuk çenojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të personelit dhe studentëve. Strukturat e vlerësimit të brendshëm kujdesen që të shmangin çdo lloj diskriminimi duke ruajtur privatësinë e informacionit dhe rezultateve që sigurojnë nga veprimtaria e tyre dhe anonimitetin e studentëve që plotësojnë formularët e vlerësimit.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KUW ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron. Që prej vitit 2019, pranë KUW është krijuar Bordi Këshillmor i Biznesit me përfaqësues nga tregu i punës me objektiv parësor bashkëpunimin me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit të ofruara apo të reja në KUW. Relacioni i takimeve të Bordit bëhet pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi. [Referenca: 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilesise.pdf; 2.25 Vendim bordi i biznesit.pdf; 2.25.1 Relaciom mbledhja e bordit biznesit.pdf; RVB Bachelor Finance-Banke.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumenti mbi politikat e sigurimit të cilësisë “Politikat për garantimin e cilësisë në KUW” është publikuar në faqen zyrtare të KUW, në mënyrë që të informohen studentët dhe të gjithë të interesuarit. Nga vëzhgimi i faqes zyrtare të internetit GVJ konstaton se ky dokument <i>nuk është i publikuar on-line.</i></p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se në faqen zyrtare të internetit të institucionit janë publikuar dy raportet e vlerësimit të cilësisë së institucionit për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020, të cilat janë të aksesueshme nga të gjitha palët e interesuara. Këto raporte respektojnë aktet ligjore mbi ruajtjen e të dhënave personale, etikën dhe privatësinë. Në takimet gjatë vizitë në KUW, GVJ u informua se faqja zyrtare në internet dhe informacionet në të ishin në proces përditësimi për shkak të riorganizimit, të kushtëzuar nga ndryshimet në strukturën e pronësisë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Bachelor Finance-Banke.pdf; https://wisdom.edu.al/njsbc; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të hartuara dhe publikuara nga KUW evidentojnë pikat e forta dhe të dobëta të institucionit, dhe përfshijnë edhe rekomandime dhe masat që duhet të merrën për përmirësimin e pikave të dobëta dhe plotësimin e mangësive. <i>[Referenca: 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit te cilesise.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>KUW e konsideron monitorimin e vlerësimit të cilësisë një proces në qendër të të gjitha aktiviteteve të KUW. Bazuar në dokumentacionin e përgatitur lidhur me politikat dhe procedurat që ndiqen nga strukturat e vlerësimit të cilësisë, si dhe relacionet dhe raportet e hartuara në bazë të gjetjeve nga veprimtaria e monitorimit të cilësisë nga NJBSC, GVJ konstaton se KUW e vlerëson dhe i jep rëndësinë e merituar këtij procesi. <i>[Referenca: 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit te cilesise.pdf; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilesise.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një nga qëllimet e monitorimit të cilësisë së aktivitetit të mësimdhënies dhe kualifikimit kërkimor shkencor, është që të promovohet kultura që çdo njësi, në fakultet, departament</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe</p>	<p>Një nga qëllimet e monitorimit të cilësisë së aktivitetit të mësimdhënies dhe kualifikimit kërkimor shkencor, është që të promovohet kultura që çdo njësi, në fakultet, departament</p>

studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	dhe individ, të cilët duhet ta konsiderojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si një përgjegjësi personale dhe kolektive. Në këtë kuadër NJBSC kryen takime periodike me studentë dhe pedagogë për t'i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e këtij procesi në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. [Referenca: 1.15 Raport vjetor i monitorimit & sigurimit te cilesise.pdf; 2.19.7 Politikat e garantimit te standarteve e cilesise.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Financë-Bankë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura fizike dhe organizative e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, krahasuar edhe me numrin aktual të studentëve;
2. Personel akademik i kualifikuar dhe i përkushtuar për një mësimdhënie cilësore;
3. Mbështetja ndaj studentëve përmes politikave të bursave dhe financimit të veprimtarive dhe aktiviteteve të tyre përtej programit të studimit;
4. KUW ka konsoliduar Revistën Shkencore “Wisdom”, ku nxiten te botojnë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi dhe studentët;

b. Pika të dobëta:

1. Pasaktësi, mungesa dhe / ose mospërputhje të Rregullores së Programit të Studimit kundrejt kuadrit tjetër rregullator të KUW dhe të syllabusit të lëndës “Praktika mësimore”;
2. Mungesa e analizave të detajuara lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit;
3. Ndarja jo e qartë e detyrave dhe përgjegjësi (dublikim i roleve) në disa struktura akademike dhe organizative të KUW;

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të rishikojë Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor në Financë-Bankë” në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator kryesor të KUW

(Statutit dhe Rregullores së institucionit) si dhe duhet të përditësohet syllabusi i lëndës “Praktika mësimore” i këtij programi studimi;

2. Rekomandohet rritja e angazhimit të Institucionit për të nxitur regjistrimin e studentëve pranë këtij programi studimi. Në vijim, KUW duhet të përditësojë studimin e tregut në koherencë me zhvillimet demografike dhe kapacitetet reale në dispozicion;
3. Institucioni duhet të realizojë një analizë e qartë dhe e detajuar lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit;
4. Institucioni duhet të riorganizojë dhe plotësojë strukturat e tij akademike dhe organizative me personel të përhershëm (akademik, ndihmës dhe administrativ) për një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësi;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Finance & Banking”

a. Strengths and affirmations:


1. The adequate infrastructure and facilities for effective teaching and learning, given the current number of students;
2. The quality and the commitment of the academic staff engaged at the study program Bachelor in “Finance & Banking”;
3. A good and comprehensive level of financial support is provided for students through scholarship policies and financial support for the extracurricular activities;
4. The KUW has consolidated its Scientific Journal “Wisdom”, where academic staff engaged in this study program and students are encouraged to publish;

b. Weak points:

1. Inaccuracies, deficiencies and / or inconsistencies of the study program regulation and of the syllabus of "Professional practice" with respect to the main regulatory framework of the institution;
2. Lack of detailed analysis of academic and logistical costs according to study programs or according to study cycles;
3. Unclear division of tasks and responsibilities (duplication of roles) in some academic and organizational structures of the institution;

Recommendations:

1. The Institution should revise and update the Regulation of the Study Program “Bachelor in Finance & Banking” in order to comply with the requirements of its main regulatory framework (The Statute and The Regulation of KUW), and as well the relative syllabus of "Professional practice" subject;
2. Higher awareness and commitment of the Institution is recommended to increase the possibilities of student enrollment in this study program. Subsequently, the KUW should revise its market research in coherence with the demographic developments and the real capacities available;



3. The Institution should carry out a clear and detailed analysis of academic and logistical costs according to study programs or to study cycles;
4. The Institution should reorganize and complete its academic and organizational structures with permanent staff (academic, auxiliary and administrative) for a clearer division of tasks and responsibilities;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X